REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I GJ

Nr. _____, datë _____2026

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10019, DATË 29.12.2008 "KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 e 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 1, pika 2 shkronja "f" ndryshohet me këtë përmbajtje:
f) Ndarja e shtetit nga partitë politike.

Pas shkronjës "f" shtohet shkronja "g" me këtë përmbajtje:
g) rregulla të tjera në lidhje me zgjedhjet.

Neni 2

Në nenin 2, shtohen përkufizimet:
"Burime Shtetërore" konsiderohen të gjitha të drejtat, privilegjet, funksionet, detyrat që burojnë nga dhe për shkak të funksionit publik ose kontrollit mbi shtetin, përfshirë por pa u kufizuar në: burime njerëzore, fonde publike, pasuri publike të luajtshme e paluajtshme, e drejta për nxjerrjen e miratimin e akteve me karakter ligjor, normativ, rregullator dhe administrativ, kontrata publike, të drejta, licenca, kanale dhe infrastrukturë komunikimi.
"Periudhë e Mbrojtur Zgjedhore" është periudha në të cilën përfshihen ndalimet e përhershme dhe kufizimet e përkohshme, gjatë së cilës ndalohet presioni politik, patronazhimi, diskriminimi, përdorimi politik i të dhënave dhe zbatimi i kontrollit selektiv, si dhe ndalohet zhvillimi/miratimi/nënshkrimi i aktiviteteve shtetërore me karakter rregullator/normativ, si dhe çdo aktivitet tjetër shtetëror me karakter njerëzor, material, kontraktual, kanale dhe infrastrukturë komunikimi që synon të japë përfitime apo diskriminime zgjedhore. "Periudhë e Mbrojtur Zgjedhore" do të jetë periudha nga data e dekretit të Presidentit për caktimin e datës së zgjedhjeve ose 4 muaj nga data e

zgjedhjeve, cilado periudhë që vjen më parë e deri në datën e formimit të qeverisë së re, ose në rastin e zgjedhjeve vendore deri në datën e betimit të Kryetarit të Bashkisë.
"Ndalimet e përhershme" janë kufizimet ligjore, të cilat ndalojnë në mënyrë të përhershme përdorimin, sjelljen dhe veprimet e funksionarëve dhe burimeve shtetërore, me qëllim ndalimin e përdorimit partiak të shtetit.
"Kufizimet e përkohshme" janë kufizime ligjore, me karakter të përkohshëm të sjelljes dhe veprimtarisë politike të punonjësve të administratës publike, me qëllim mbrojtjen nga presioni politik dhe përdorimi abuziv i të drejtave politike të tyre, si dhe respektimin e parimit të neutralitetit të shtetit gjatë procesit zgjedhor.

Në nenin 2, shkronja "ç" e pikës 18, riformulohet me përmbajtjen si vijon:
ç) rezultatin e votimit për çdo alternativë në referendum për votimet brenda dhe nga jashtë Shqipërisë, sipas dispozitave të këtij Kodi.

Neni 3

1.**Në nenin 3, pika 5/1 ndryshohet dhe riformulohet me përmbajtjen si vijon:**
"Subjektet zgjedhore përfitojnë financime publike dhe jopublike në mbështetje të fushatës së tyre, sipas dispozitave ligjore të këtij Kodit Zgjedhor".

2. **Në nenin 3, pika 7 ndryshohet dhe riformulohet me përmbajtjen si vijon:**
"Shteti dhe partitë politike janë të ndara në procesin zgjedhor. Funksioni, autoriteti dhe burimet publike nuk përdoren për të krijuar përfitime ose diskriminime zgjedhore. Ushtrimi neutral dhe i pandërprerë i funksioneve publike garantohet në çdo fazë të procesit zgjedhor.
3. **Pas pikës 7, shtohet pika 7/1 me përmbajtjen si vijon:**
"Ndalohet vënia në përdorim të subjekteve zgjedhore i mjeteve, fondeve, materialeve dhe pasurive të ndryshme pronë publike, miratimi i akteve rregullatore që japin

përfitime për kategori të caktuara të popullatës, si dhe përdorimi i burimeve njerëzore të administratës publike të çdo niveli.

4. **Në nenin 3, pika 8 ndryshohet dhe riformulohet me përmbajtjen si vijon:**
"Administrata publike është neutrale. Institucionet e administratës publike, të çdo niveli, me veprimet ose mosveprimet e tyre nuk duhet të cenojnë zhvillimin e zgjedhjeve".

5. **Në nenin 3, shtohet pika 9 me përmbajtjen si vijon:**
"Policia e Shtetit i ushtron detyrat e veta në shërbim të zgjedhjeve në paanshmëri të plotë ndaj subjekteve zgjedhore. Veprimtaria e saj zhvillohet sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të miratuara nga KQZ-ja".

Neni 4

Në nenin 12 bëhen këto shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:
a) Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
b) Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
b) Komisioni Rregullator; dhe
c) Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve.
2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:
"3/1. Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është organ monokratik, funksionalisht i pavarur, përgjegjës për mbikqyrjen dhe garantimin e neutralitetit të shtetit gjatë procesit zgjedhor sipas parashikimeve të këtij Kodi Zgjedhor".
3. Në fund të pikës 5 shtohen fjalitë:
"Për çështjet e neutralitetit shtetëror, KAS-i vihet në lëvizje drejtpërdrejt nga Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ose pala e interesuar.".

Neni 5

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 14
Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

1. Nënkomisioneri zgjidhet nga Kuvendi për një mandat shtatëvjeçar, të përtëritshëm. Kriteret për kandidimin, papajtueshmëritë, pasurinë, konfliktin e interesave, shkarkimin dhe vakancën zbatohen kushtet e garancitë e përcaktuara për Komisionerin, për aq sa ky Kod nuk parashikon ndryshe. Pas përfundimit të mandatit shtatëvjeçar Nënkomisioneri Shetëror i Zgjedhjeve qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e Nënkomisionerit të ri.
2. Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve monitoron, zhvillon hetim administrativ, kërkon informacion e dokumente, siguron provat dhe vendos masa parandaluese e rivendosëse në mënyrë diskrecionale për ndarjen e shtetit nga partia. Ai ia paraqet

KAS-it kërkesën për sanksion dhe i referon pa vonesë organit kompetent të ndjekjes penale faktet që tregojnë kryerjen e një vepre penale.
3. Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të tij ku përcaktohen afatet dhe procedurat e hetimit dhe vendimmarrjes administrative, në përputhje me parashikimet e këtij Ligji Zgjedhor.
4. Fusha e përgjegjësisë dhe kompetenca e ushtrimit të veprimtarisë së Nënkomisionerit përfshin dhe shtrihet mbi pushtetin normativ, fiskal e social, buxhetin, punonjësit shtetërorë dhe personelin publik, prokurimet, koncesionet, lejet minerare, ankandet, investimet, pasurinë, shërbimet, procedurat administrative, kontrollin e inspektimin, të dhënat, veprimtaritë zyrtare dhe komunikimin institucional. Për ndalimet e përhershme, kompetenca ushtrohet edhe jashtë periudhës zgjedhore, pa zëvendësuar organet sektoriale. Mbështetja administrative dhe qasja në informacion nuk mund t'i kufizohen nga Komisioneri.
5. Nënkomisioneri mbështetet dhe drejton një strukturë të posaçme juridike, hetimore e teknike, brenda strukturës dhe organikës së KQZ, ku përfshihen edhe inspektorë të atashuar në çdo qark. Komisioneri me propozim të Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i përcjell për miratim Kuvendit së bashku me strukturën dhe organikën e administratës së KQZsë, edhe organikën e strukturës së posaçme juridike së KQZ-së, për garantimin e neutralitetit të Shtetit gjatë zgjedhjeve.
6. Komisioneri nuk ndërhyn në fillimin, zhvillimin, administrimin e provave ose përfundimin e procedurave të Nënkomisionerit. Mosmarrëveshjet për mbështetjen administrative nuk pezullojnë kompetencat ligjore.
7. Vendimet dhe mosveprimi i Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kundërshtohen drejtpërdrejt në KAS dhe, më tej, në Kolegjin Zgjedhor sipas këtij Kodi.
8. Nënkomisioneri zbaton gjithashtu detyrat dhe kompetencat e tjera sipas parashikimeve të këtij Kodi.
9. Paga dhe trajtimi financiar janë të njëjta me ato të Komisionerit.".

Neni 6

Pas nenit 17 shtohet neni 17/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 17/1
Zgjedhja e Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

1. Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve zgjidhet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me jo më pak se tre të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
2. Kandidatët për Nënkomisioner, që i nënshtrohen votimit propozohen nga partia më e madhe e opozitës parlamentare. Në procedurën e votimit paraqiten jo më shumë se 3 kandidatura. Kandidati i cili arrin të sigurojë jo më pak se tre të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit zgjidhet Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
3. Në rast se gjatë raundit të parë të votimit nuk rezulton fitues asnjë nga kandidatët në garë, zhvillohet një raund i dytë votimi. Në këtë raund i nënshtrohen votimit dy kandidatët më të votuar në raundin e parë. Në rast se nga raundi i parë rezulton se dy

ose më shumë kandidatë kanë marrë vota të barabarta, dy kandidatët që futen në votim në raundin e dytë zgjidhen me short.
4. Kandidati që merr më shumë vota në raundin e dytë të votimit zgjidhet Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Votimi është i vlefshëm kur merr pjesë më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve.
5. Në çdo rast rast kandidaturat për funksionin e Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve propozohen nga partia më e madhe e opozitës parlamentare.

Neni 7

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli ndryshohet si më poshtë: "Shkarkimi i Komisionerit, Nënkomisionerit dhe anëtarëve të Rregullatorit e të KAS-it".
2. Në fjalinë e parë të pikës 1, fjalët "Shkarkimi i Komisionerit" zëvendësohen me fjalët "Shkarkimi i Komisionerit ose i Nënkomisionerit".
3. Në pikën 5, fjalët "Komisioneri, anëtarët" zëvendësohen me fjalët "Komisioneri, Nënkomisioneri, anëtarët".
4. Në fjalinë e parë të pikës 6, pas fjalëve "Kur Komisioneri," shtohen fjalët "Nënkomisioneri,".

Neni 8

Në nenin 19, pika 1, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "f" shfuqizohet.
2. Në shkronjën "n", fjalët "Rregullatorit ose KAS-it" zëvendësohen me fjalët "Rregullatorit, KAS-it ose Nënkomisionerit".

Neni 9

Në nenin 20, pika 1, shkronja "c" ndryshohet si më poshtë:

"c) rregullat teknike të raportimit, autentifikimit, administrimit, ndërveprimit, arkivimit dhe publikimit të informacionit për neutralitetin e shtetit dhe veprimtaritë publike, brenda kufijve të parashikuara në këtë Kod.

Neni 10

1. Në nenin 21, pika 1, pas shkronjës "b" shtohet shkronja "b/1" me këtë përmbajtje:
"b/1) shqyrton ankimet ndaj vendimeve dhe mosveprimit të Nënkomisionerit, vendos mbi themelin e ankimit kur plotësohen kushtet e këtij Kodi dhe kontrollon masat parandaluese e rivendosëse;".

2. Në fund të shkronjës "dh" shtohet fjalia:
"Për shkeljet e neutralitetit shtetëror, kërkesa paraqitet drejtpërdrejt nga Nënkomisioneri.".

Neni 11

Neni 25/1, pika 3, ndryshohet si më poshtë:
Fletët e votimit të plotësuara nga zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të sekretuara dërgohen në adresën zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet shërbimit postar. Në cdo rast zarfi që mban fletën e votimit duhet të jetë i vulosur me vulën e zyrës postare nga ku votuesi e dërgon. Shpenzimet për dërgimin dhe kthimin e fletës së votimit dhe çdo materiali tjetër zgjedhor dhe informativ nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tek votuesit nga jashtë paguhet nga KQZ-ja. KQZ-ja fillimisht bën përpjekje të përzgjedhë ofrues ndërkombëtarë të shërbimit postar me jashtë vendit, që kanë eksperiencë dhe reputacion të mirë në shërbimin e postës së shpejtë, dhe zgjedhja e tij realizohet nëpërmjet procedurave më afatshkurtra që mundëson legjislacioni për prokurimin publik.

Neni 12

Neni 67 "Lista e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të partive politike" ndryshohet si më poshtë:
1. Partia politike, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj, jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve. Emrat në listën shumemërore të dorëzuar nga Partia, renditen sipas rendit alfabetik të mbiemrit për secilin prej tyre dhe i nënshtrohen votimit parapëlqyes. Zgjedhësit shprehin parapëlqimin për 5 kandidatë nga lista shumemërore.
2. Partia politike, pjesëtare e një koalicioni, depoziton në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve. Emrat në listën shumemërore të dorëzuar nga Partia, renditen sipas rendit alfabetik të mbiemrit për secilin prej tyre dhe i nënshtrohen votimit parapëlqyes. Zgjedhësit shprehin parapëlqimin për 5 kandidatë nga lista shumemërore të një prej partive pjesëtare të koalicionit.
3. Numri i përgjithshëm i kandidatëve në listën shumemërore të partisë politike ose në listën shumemërore të koalicionit zgjedhor, nuk mund të jetë më i vogël se 140. Për një parti pjesëtare të koalicionit, numri i kandidatëve nuk mund të jetë më i vogël se një e treta e mandateve që zgjidhen në shkallë vendi.
4. Listat shumemërore duhet të përfshijnë të paktën në tridhjetë për qind të tyre, gjininë më pak të përfaqësuar.
5. Kandidati për deputet, i regjistruar në një listë shumemërore nuk mund të përfshihet në një listë shumemërore të një partie apo koalicion tjetër dhe as si i propozuar nga një grup zgjedhësish.

6. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista shumemërore e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve.
7. Kandidati për kryetar bashkie dhe listat shumemërore për këshillin e bashkisë, territori i të cilave nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme, regjistrohen në KQZ.
8. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, për çdo këshill bashkie, lista shumemërore në jo më pak se pesëdhjetë për qind të tyre, duhet t'i përkasë gjinisë më pak të përfaqësuar. Emrat në listën shumemërore të dorëzuar nga partia, ose nga koalicioni zgjedhor, renditen sipas rendit alfabetik të mbiemrit për secilin prej tyre dhe i nënshtrohen votimit parapëlqyes. Zgjedhësit shprehin parapëlqimin për 5 kandidatë nga lista shumemërore.

Neni 13

Neni 74, ndryshohet si më poshtë:
1. Republika e Shqipërisë përbëhet nga një zonë e vetme zgjedhore, e cila përputhet me territorin e të gjithë vendit dhe shërben për zgjedhjen e 140 deputetëve, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod.
2. Bashkia përbën një zonë të vetme zgjedhore. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kufijtë administrativë të njësive vendore caktohen në përputhje me përcaktimet e ligjit mbi ndarjen administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Neni 14

Neni 75, ndryshohet si më poshtë:
Titulli i nenit 75 ndryshohet me këtë përmbajtje:
Caktimi i numrit të mandateve për kuvendin e Shqipërisë dhe për këshillat e qeverisjes vendore.

1. Republika e Shqipërisë përbëhet nga një zonë zgjedhore.
2. Numri i mandateve për këshillat vendore, caktohet në përputhje me përcaktimet e ligjit Vetëqeverisjen Vendore të Republikës së Shqipërisë.

Neni 15

Neni 76, pika 1, riformulohet si më poshtë vijon:
1. Si rregull 4 muaj para datës së fillimit të periudhës zgjedhore, që i paraprin fundit të mandatit të Kuvendit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me kërkesë të KQZ-

së, dërgon numrin e përgjithshëm të shtetasve, bazuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.
2.Neni 76, pika 2 dhe 3 shfuqizohen.

Neni 16

Në pjesën VII bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i pjesës ndryshohet si më poshtë:

"FINANCIMI I ZGJEDHJEVE DHE NEUTRALITETI I SHTETIT".

2. Titulli i kreut I ndryshohet si më poshtë:

"BURIMET DHE ADMINISTRIMI I FINANCIMIT".

3. Përpara nenit 91 shtohen titujt e kreut II dhe të seksionit I, me këtë përmbajtje:

"KREU II
NEUTRALITETI I SHTETIT
SEKSIONI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME".

4. Neni 91 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 91
Ndarja e shtetit nga partia

1. Ndalohet përdorimi i funksionit, autoritetit, veprimtarisë dhe burimeve publike për të mbështetur ose dëmtuar një parti politike, subjekt zgjedhor, kandidat ose ushtrimin e lirë të të drejtave politike të zgjedhësit.
2. Ndalimi zbatohet ndaj organeve qendrore e vendore, institucioneve të pavarura, enteve publike dhe shoqërive ku shteti ose njësitë vendore zotërojnë votat ose shumicën e organit administrues a mbikëqyrës, apo edhe nëse zotërojnë kapital. Përfshihen personat që veprojnë për llogari të tyre ose përdorin burime publike me kërkesë, autorizim, financim ose bashkërendim institucional të provuar.
3. Ndalohet urdhërimi, organizimi, detyrimi, nxitja me përfitim ose kërcënimi i punonjësve publikë dhe nxënësve për pjesëmarrje, promovim ose veprimtari politike apo zgjedhore, përfshirë veprimtari digjitale.
4. Gjatë periudhës së mbrojtur zgjedhore ndalohet marrja në punë, pushimi, lirimi, transferimi dhe lëvizja në detyrë në institucionet e entet publike, përveç shkaqeve të përligjura, objektive e të dokumentuara. Përjashtohen nga ky kufizim masat e marra për shkelje reale të ligjit, plotësimi i pozicioneve brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës për përmbushjen e misionit dhe nevojat e emergjencës nga ngjarje të paparashikuara.
5. KQZ-ja përcakton me akt normativ metodologjinë teknike të verifikimit dhe dokumentimit, pa krijuar ndalime, elementë të kundravajtjeve ose përjashtime të reja

përtej parashikimeve të këtij Kodi. Mos miratimi i akteve normative mbi metodologjinë e verifikimit dhe dokumentimit të shkeljeve dhe ndalimeve të përdorimit të burimeve shtetërore, me qëllim marrjen e avantazheve zgjedhore, nuk pengon zbatimin e ndalimeve sipas ligjit dhe nuk ligjëron një veprimtari të ndaluar.
6. Ndalimet e përhershme dhe kufizimet e përkohshme zbatohen sipas neneve 91/1–91/35. Veprimtaria e zakonshme, objektive dhe e paanshme e shtetit vijon në çdo fazë".

Neni 17

Pas nenit 91 shtohen nenet 91/1 deri në 91/35 dhe titujt e seksioneve II deri në IX të kreut II të pjesës VII, me këtë përmbajtje:

"Neni 91/1
Periudhat dhe zona e zbatimit
1. Ndalimet e patronazhimit politiko-administrativ, presionit, kushtëzimit politik të punësimit e shërbimit, përdorimit politik të pushtetit kontrollues dhe përdorimit të paligjshëm të të dhënave zbatohen në çdo kohë brenda dhe jashtë vendit. Ndalohet në çdo kohë krijimi ose përdorimi i platformave, listave, kuotave, pikëzimit, renditjes ose raporteve për matjen e aktivitetit politik të personelit.
2. Për veprimtarinë e pushtetit normativ, fiskal e social dhe veprimtarinë ekonomike publike, si dhe përdorimin e burimeve shtetërore, periudha e zbatimit fillon në datën më të hershme ndërmjet dekretimit dhe katër muajve përpara votimit dhe vijon deri në marrjen efektive të detyrës nga Këshilli i ri i Ministrave ose organi i ri ekzekutiv vendor, sipas zgjedhjeve përkatëse dhe ka efekt për kategoritë e popullsisë brenda dhe jashtë vendit.
3. Për veprimtaritë zyrtare dhe komunikimin institucional, periudha fillon në datën më të hershme ndërmjet dekretimit dhe katër muajve përpara votimit dhe përfundon me mbylljen e votimit dhe aplikohet brenda dhe jashtë vendit.
4. Për veprimtarinë ekonomike, periudha fillon në datën më të hershme ndërmjet dekretimit të zgjedhjeve dhe katër muajve përpara votimit dhe vijon deri në marrjen efektive të detyrës nga Këshilli i ri i Ministrave ose organi i ri ekzekutiv vendor. Gjatë kësaj periudhe do të mbeten të ndaluara ekzekutimi i masave të konstatuara të paligjshme dhe vendimmarrja e re jashtë vazhdimësisë normale, sipas dispozitave përkatëse. Pagesat e maturuara dhe shërbimet e ligjshme vijojnë.
5. Për administratën zbatohen nenet 91/4 gjer në nenin 91/6. Mbrojtja nga hakmarrja politike është e përhershme.
6. Në zgjedhjet vendore dhe të pjesshme, kufizimet lidhen me territorin dhe objektin e garës, përfshirë veprimet e autoriteteve qendrore me ndikim të drejtpërdrejtë në të.

Neni 91/2
Ndalimi i përdorimit të funksioneve publike për përfitime zgjedhore dhe vlerësimi i provave

1. Gjatë periudhës së mbrojtur zgjedhore, ndalohet përdorimi i kompetencës, kohës, territorit, përfituesve, përshpejtimit të pajustifikuar të grafikut të zbatimit, vlerës ose komunikimit për ta shndërruar funksionin publik në përfitim zgjedhor, apo mjet presioni, shpërblimi ose hakmarrje politike.
2. Parashikimi i mëparshëm në buxhet, plan ose kontratë është provë që vlerësohet dhe nuk përbën përjashtim automatik nga kontrolli.
3. Masa parandaluese kërkon indicie konkrete dhe rrezik aktual. Sanksioni administrativ kërkon provimin e elementeve ligjore dhe fajësisë. Përgjegjësia penale dhe pavlefshmëria vlerësohen sipas kushteve të tyre ligjore.
4. Anomalia statistikore, afërsia me votimin ose ndryshimi i grafikut të zbatimit, veçmas, janë tregues verifikimi dhe jo provë përfundimtare ose prezumim fajësie.
5. Organi publik paraqet dokumentet për kriteret, planifikimin, shkaqet dhe domosdoshmërinë e veprimit. Ky detyrim nuk përmbys barrën e provës për sanksionimin ose prezumimin e pafajësisë në procesin penal.
6. Kontrolli zgjedhor nuk zëvendëson drejtimin profesional të riskut, vlerësimin e ofertave, administrimin e kontratës, mbikëqyrjen e të dhënave, auditimin ose hetimin penal.

Neni 91/3
Përgjegjësia dhe mbrojtja e punonjësit

1. Përgjegjësia e punonjësve shtetërorë lidhet me veprimin ose mosveprimin konkret, kompetencën, rolin e urdhëruesit, organizatorit, koordinatorit, ndërmjetësit, zbatuesit e përfituesit dhe fajësinë e kërkuar nga dispozita përkatëse.
2. Ndalohet kërkimi, urdhërimi, kushtëzimi ose monitorimi i sjelljes politike të punonjësit nëpërmjet funksionit publik ose marrëdhënies së varësisë, brenda ose jashtë kohës së punës.
3. Ndalohet trajtimi i pafavorshëm për raportimin, refuzimin e urdhrit të paligjshëm, dhënien e provës ose pjesëmarrjen në kontroll. Identiteti mbrohet sipas legjislacionit për sinjalizimin dhe të dhënat personale.
4. Refuzimi i urdhrit të paligjshëm dhe raportimi me mirëbesim mbrohen. Presioni i provuar merret parasysh në individualizimin e sanksionit administrativ. Punonjësi që raporton në kohë dhe bashkëpunon, kur provohet se ka vepruar nën presion, mund të përjashtohet nga sanksioni administrativ ose t'i ulet ai, përveçse kur ka kryer në mënyrë të pavarur shkelje tjetër të rëndë. Kjo nuk përjashton përgjegjësinë penale sipas ligjit.
5. Nënkomisioneri merr masa të përkohshme për ndalimin e hakmarrjes dhe ruajtjen e gjendjes së punësimit brenda kompetencave të këtij Kodi; anulimi, rikthimi dhe kompensimi përfundimtar ndiqen sipas statusit dhe juridiksionit përkatës.

SEKSIONI II
NEUTRALITETI I ADMINISTRATËS

Neni 91/4
Ndalimet, Kufizimet dhe të drejtat e administratës shtetërore gjatë periudhës së mbrojtur

1. Gjatë periudhës së mbrojtur zgjedhore, Administrata Shtetërore respekton parimin e neutralitetit të administratës ndaj veprimtarisë politike të partive politike dhe subjekteve zgjedhore.
2. Gjatë periudhës së mbrojtur zgjedhore, ndalohet pjesëmarrja në aktivitete politike dhe veprimet aktive politike të administratës shtetërore, me qëllim përfitimin apo diskriminin zgjedhor.
3. Gjatë periudhës së mbrojtur zgjedhore, ndalohet organizimi i punonjësve të administratës shtetërore si audiencë, sfond ose demonstrim mbështetjeje në veprimtari zyrtare ose zgjedhore.
4. Ndalohet përdorimi i uniformave, hierarkisë ose listave të pranisë në aktivitete për demonstrim politik.
5. Përjashtohen nga detyrimi i zbatimit të parimit të neutralitetit të administratës, funksionarët politike të administratës shtetërore.
6. Lejohet pjesëmarrja dhe emërimi i punonjësve të administratës shtetërore në komisionet zgjedhore. Në këto raste, punonjësit shtetërorë pezullohen nga ushtrimi i detyrave dhe funksioneve shtetërore, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së pjesëmarrjes së tyre në komisionet zgjedhore.
7. Lejohet pjesëmarrja e organizuar e punonjësve të administratës shtetërore në aktivitete publike vetëm në masën objektivisht të nevojshme për emergjencën, sigurinë, shëndetin publik, arsimin ose trajnimin e detyrueshëm, ofrimin e shërbimit, kompetencën ligjore ose detyrimin ndërkombëtar.
8. Bindja politike dhe vota e punonjësve të administratës shtetërore kurdoherë mbeten të lira.

Neni 91/5
Ndalimet, Kufizimet dhe të drejtat e administratës shtetërore gjatë fushatës zgjedhore

1. Gjatë fushatës zgjedhore e deri në përfundimin e votimit, krahas ndalimeve të përcaktuara në nenin 91/4, punonjësit e administratës shtetërore ndalohen të ndërveprojnë publikisht në rrjetet sociale lidhur me aktivitetet apo veprimet me karakter politik e zgjedhor. Këtu përfshihen aktivitete e veprime të tilla si pëlqimi ose reagimi publik, shpërndarja ose ripostimi, komenti publik mbështetës dhe thirrja publike për votë ndaj përmbajtjes zgjedhore që promovon ose kundërshton subjektin zgjedhor ose kandidatin. Ndalimi nuk përfshin ndjekjen e profileve, leximin, shikimin, ruajtjen, kërkimin e informacionit, kopjimin e lidhjes dhe përcjelljen në komunikimin individual privat. Verifikimi realizohet në përputhje me kuadrin ligjor për trajtimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Ndalohet në çdo kohë krijimi ose përdorimi i platformave, listave të zgjedhësve, pikëzimit, renditjes ose raporteve për matjen e aktivitetit politik të personelit.
3. Ndalohet përdorimi i të dhënave politike për rekrutim, vlerësim, vijimin e marrëdhënieve të punësimit, promovim, transferim, shpërblim ose disiplinim.
4. Lejohen veprimtaritë dhe kryerja e aktiviteteve lidhur me shërbimet për sigurinë, shërbimin, ndihmën shëndetësore, administrimin ose vëzhgimin e ligjshëm, për sa kohë personi nuk merr pjesë si mbështetës politik.

Neni 91/6
Regjimi i përkohshëm dhe mbrojtja paszgjedhore

1. Kufizimet e posaçme të pjesëmarrjes dhe shprehjes publike të punonjësve të administratës shetërore, zbatohen gjatë periudhës së mb rojtur zgjedhore për një afat pesë vjeçar nga hyrja në fuqi e ligjit që i vendos ato dhe shuhen automatikisht me mbarimin e këtij afati.
2. Regjimi rinovohet vetëm një herë, me ligj, për jo më shumë se pesë vjet, pas vlerësimit publik të dokumentuar të presionit, patronazhimit, zbatimit të masave dhe efektivitetit të mjeteve më pak kufizuese. KQZ-ja i paraqet Kuvendit vlerësimin gjashtë muaj para mbarimit të afatit.
3. Pas përfundimit të afatit sipas pikave 1 dhe 2, do të mbeten në fuqi ndalimet e përdorimit politik të funksionit, presionit, patronazhimit politiko - administrativ, monitorimit dhe të dhënave, si dhe kufizimet funksionale të statusit. Pjesëmarrja individuale pasive dhe pëlqimi politik i nënshtrohen regjimit të zakonshëm.
4. Nga votimi deri në transferimin efektiv të funksionit ndalohen masat e punësimit, transferimit, disiplinës, mosrinovimit ose largimit që shpërblejnë ose ndëshkojnë sjelljen politike a zgjedhore. Administrimi normal dhe i dokumentuar i personelit vijon.

SEKSIONI III
MASAT FISKALE DHE SOCIALE

Neni 91/7
Përfitimet publike për qëllime përfitimi zgjedhor dhe kushtet e lejimit

1. Gjatë periudhës së mbrojtur zgjedhore ndalohet propozimi, miratimi, nxjerrja, shpallja si angazhim shtetëror, zbatimi ose ekzekutimi i masave që krijojnë, zgjerojnë, rrisin, përshpejtojnë ose materializojnë përfitime publike për qëllime përfitimi zgjedhor, për kategori të caktuara të popullatës, kur nuk përbëjnë ushtrim normal, të parashikueshëm dhe objektiv të funksionit.
2. Masat përfshijnë propozimin, hartimin, futjen për miratim, miratimin, dekretimin dhe botimin në fletore zyrtare të ligjeve, akteve normative me fuqinë e ligjit, akteve nënligjore të përgjithshme e vendore, rregullatore, delegime dhe amendamente që krijojnë të drejtën, fondin, mekanizmin ose kushtin për përfitimin.
3. Përfitimi përfshin pagën, pensionin, bonusin, ndihmën, subvencionin, kompensimin, transfertën, lehtësimin fiskal, amnistinë fiskale, uljen, faljen, shtyrjen ose mosekzekutimin e detyrimit, pasurinë dhe çdo avantazh ekonomik ose social të krahasueshëm.

4. Masa vlerësohet sipas natyrës, përfituesve, vlerës, shtrirjes, kohës së propozimit e materializimit, parashikimit të mëparshëm, vazhdimësisë, diskrecionit, komunikimit dhe mundësisë së shtyrjes pa dëmtuar interesin publik.
5. Lejohen zbatimi i detyrimeve automatike ligjore, indeksimet e bazuara në formula ekzistuese me kushtin që të jenë të miratuara dhe materializuara jashtë periudhës së mbrojtur zgjedhore, pagesat periodike, zbatimi i vendimeve gjyqësore, buxhetimi normal dhe masat objektivisht të domosdoshme për emergjencat, në rastet kur nuk ndryshohen në mënyrë të rëndësishme përfituesit, vlera, formula, afati ose grafiku i zbatimit.
6. Përjashtimet për fatkeqësi, emergjencë, detyrim ndërkombëtar ose nevojë tjetër objektive të jashtëzakonshme të parashikuar shprehimisht me ligj lejohen vetëm kur masa është e domosdoshme, proporcionale, e dokumentuar dhe nuk mund të shtyhet.

Neni 91/8
Përfitimet e pamaterializuara

1. Kur masa është miratuar përpara periudhës së mbrojtur zgjedhore, por përfitimi ose efekti nuk është materializuar dhe masa ose ndryshimi, përshpejtimi, zgjerimi a materializimi i saj do të ishte i ndaluar po të vendosej gjatë kësaj periudhe, ekzekutimi dhe prodhimi i efektit të masës/aktit do të pezullohen deri në në fund të periudhës së mbrojtur zgjedhore, përveçse kur masa anulohet ose shfuqizohet më parë nga organi kompetent.
2. Nuk cenohen efektet e materializuara përpara periudhës dhe as pagesat periodike normale, detyrimet e ekzekutueshme, formulat automatike ose skemat e qëndrueshme të mëparshme, pa ndryshim të vlerës, përfituesve, formulës, afatit ose grafiku i zbatimit.
3. Vendimi për të përshpejtuar, shtyrë, përzgjedhur ose promovuar përfituesit, i nënshtrohet kontrollit edhe kur akti bazë është miratuar përpara periudhës së mbrojtur zgjedhore.
4. Për masat me fuqi ligjore zbatohen kufijtë e nenit 91/10, pika 7. KQZ nuk pezullon ose shfuqizon ligjin dhe nuk zëvendëson kontrollin kushtetues.

Neni 91/9
Buxheti dhe kontrolli paraprak

1. Subjekt i verifikimit dhe kontrollit nga KQZ, me qëllim ndalimin e përfitimeve zgjedhore janë edhe Buxheti dhe paketa fiskale.
2. Nënkomisioneri ka të drejtë të verifikojë dispozitat dhe ndryshimet që krijojnë, rrisin, zgjerojnë, përshpejtojnë ose rikonfigurojnë përfitime gjatë periudhës së mbrojtur zgjedhore. Shpenzimet e vazhdimësisë, borxhi, kontratat dhe formulat e mëparshme objektive vijojnë.
3. Projektet e nisura përpara dekretit kontrollohen në versionin dhe fazën e proceduar pas tij.
4. Masat fiskale, sociale dhe buxhetore shoqërohen me formularin e Aneksit A të këtij Kodi, numër unik dhe versionin e plotë.
5. Kontrolli paraprak nga KQZ nuk është autorizim diskrecional për përfitim të ndaluar.

Neni 91/10
Amendamentet e buxhetit të shtetit dhe kufijtë e kontrollit

1. Ndryshimi i përfituesve, vlerës, barrës fiskale, afatit, hyrjes në fuqi ose materializimit të buxhetit të shtetit është ndryshim me rëndësi zgjedhore dhe regjistrohet si version i ri, pavarësisht përqindjes së tekstit që ndryshohet.
2. Ndalohet propozimi i projekt akteve apo ndryshimeve në buxhetin e shtetit që synojnë të japin përfitime zgjedhore gjatë periudhës së mbrojtur zgjedhore, sipas parashikimeve të këtij Kodi.
3. Programet politike për mandatin e ardhshëm nuk ndalohen kur paraqiten qartë si program zgjedhor për zbatim pas zgjedhjeve.
4. Për aktet administrative dhe veprimet ekzekutive, ndalimi zbatohet sipas fazës: mosprocedim, mosekzekutim, ndalim pagese ose masë e kufizuar rivendosëse, sipas ligjit dhe vendimit të ekzekutueshëm.
5. Për projektligjet zbatohen detyrimet e këtij Kodi dhe Rregullores së Kuvendit.
6. Nënkomisioneri, KAS-i dhe Kolegji nuk shfuqizojnë ligje dhe nuk pezullojnë fuqinë e tyre ose të akteve normative me fuqinë e ligjit. Ata konstatojnë shkeljen zgjedhore dhe marrin masa brenda kompetencave ligjore. Për kushtetutshmërinë vihet në lëvizje Gjykata Kushtetuese nga subjektet e legjitimuara.
7. Kontrolli i projekt aktit zhvillohet përpara miratimit, përveçse kur nevoja dhe urgjenca e bëjnë objektivisht të pamundur. Në rast miratimi të një akti të ndaluar sipas këtij Kodi, kontrolli nis menjëherë pas botimit dhe pa ndryshuar afatet, fuqinë juridike dhe kompetencat kushtetuese. Kontrolli synon evidentimin e efekteve përfituese zgjedhore, personat përgjegjës dhe marrjen masave përkatëse sipas parashikimeve të këtij Kodi.

SEKSIONI IV
VEPRIMTARIA EKONOMIKE PUBLIKE

Neni 91/11
Neutraliteti i veprimtarisë ekonomike publike

1. Gjatë periudhës së mbrojtur zgjedhore ndalohet përdorimi i buxhetit, prokurimeve, investimeve, kontratave dhe pasurisë publike për të krijuar përfitim ose diskriminim zgjedhor nëpërmjet devijimit të pajustifikuar të planifikimit, financimit, procedurës, territorit, vlerës, përshpejtimi i grafikut të zbatimit ose kohës së ekzekutimit.
2. Ndalimi i devijimit shtrihet nga data e dekretimit të zgjedhjeve ose 4 muaj përpara datës së votimit, e deri në datën e zgjedhjeve, cilado datë që vjen më parë.
3. Nga përfundimi i votimit deri në formimin e qeverisë së re ose marrjen e detyrës së organit të zgjedhur vendor, mbeten të ndaluara ekzekutimi i masave të konstatuara të paligjshme dhe vendimmarrja e re e kufizuar shprehimisht nga dispozitat përkatëse, ndërsa pagesat e maturuara dhe shërbimet e ligjshme vijojnë.
4. Ndalimet zbatohen ndaj autoriteteve qendrore e vendore, institucioneve buxhetore, organeve kontraktore, enteve dhe shoqërive nën kontroll publik, si dhe personave që veprojnë për llogari të tyre me burime publike.
5. Për zgjedhjet e pjesshme zbatohet lidhja reale territoriale dhe materiale me zgjedhjet përkatëse.

6. Veprimtaria normale ekonomike shtetërore dhe ekzekutimi i detyrimeve ligjore, administrative e kontraktuale nuk ndërpritet.
7. Përfshirja e mëparshme e një mase në buxhet, plan prokurimi ose program investimi, i cili shtrin efektin gjatë periudhës së mbrojtur zgjedhore, nuk e përjashton kontrollin e ndryshimit ose të ekzekutimit të saj.

Neni 91/12
Devijimi zgjedhor dhe vijimësia normale

1. Devijimi zgjedhor vlerësohet në përputhje me afatin dhe procedurën standarde duke evidentuar devijimin nga plani ose kontrata, selektivitetin territorial apo sektorial, kohën dhe lidhjen objektive me konkurrimin zgjedhor.
2. Vlerësohet nëse masa do të realizohej në të njëjtën kohë, territor, vlerë dhe ritëm edhe në mungesë të zgjedhjeve, duke u mbështetur në dokumente dhe të dhëna të verifikueshme. Afërsia me zgjedhjet ose një anomali statistikore, e vetme, përbën indicie për verifikim dhe jo provë përfundimtare të shkeljes. Ndryshimi material i objektit, vlerës, financimit, kalendarit, territorit ose grafiku i zbatimit, i nënshtrohet verifikimit të posaçëm.
3. Lejohet ekzekutimi i detyrimeve të maturuara, kontratat dhe projektet shumëvjeçare sipas grafikut të dokumentuar, furnizimet periodike, mirëmbajtja e zakonshme dhe shërbimet esenciale.
4. Në rastet e emergjencës lejohet veprimi i domosdoshëm, proporcional dhe i dokumentuar, me njoftim pa vonesë dhe kontroll të mëpasshëm. Përjashtimi nuk lejon promovim zgjedhor.

Neni 91/13
Buxheti dhe prokurimet

1. Nënkomisioneri verifikon rialokimet, përdorimin e fondeve rezervë, shtesat financiare, transfertat drejt njësive vendore, parapagimet dhe përshpejtimi i disbursimeve, me qëllim evidentimin e devijimit zgjedhor të pajustifikuar.
2. Institucioni Publik ka detyrimin të dokumentojë planin fillestar, ndryshimin, shkaqet, përfituesit, shpërndarjen territoriale dhe kalendarin e pagesave.
3. Lejohet ekzekutimi i pagesave të maturuara sipas kontratave të ligjshme e të ekzekutuara, përveçse në rastet kur ekziston bazë ligjore e posaçme dhe vendim i ekzekutueshëm për ndalimin e tyre.
4. Kontrolli përfshin ndryshimet e regjistrit të parashikimeve, zgjedhjen dhe përshpejtimin e procedurës, shpalljen, kontraktimin, ndryshimet e kontratës dhe urdhrat e ekzekutimit.
5. Procedurat me negocim pa shpallje paraprake dhe procedurat me afate të përshpejtuara, kur nisen ose ndryshohen materialisht gjatë periudhës së mbrojtur zgjedhore, lejohen vetëm kur ato përmbushin kushtet e legjislacionit për prokurimin publik, si dhe kufizimet shtesë zgjedhore të këtij neni.
6. Për lejimin gjatë periudhës së mbrojtur zgjedhore, kërkohet provë e dokumentuar e domosdoshmërisë objektive, e pamundësisë së shtyrjes ose e ndjekjes së procedurës së zakonshme dhe, kur urgjenca është shkak ligjor i përdorur, e rrethanave të paparashikueshme që nuk i atribuohen autoritetit. Vonesa ose mangësia e planifikimit

e shkaktuar nga vetë autoriteti nuk justifikon shmangien e regjimit të zakonshëm. Kushtet e posaçme zgjedhore nuk ndryshojnë kriteret e ligjshmërisë sektoriale të prokurimit.
7. Procedurat e zakonshme të prokurimit vijojnë pa autorizim paraprak zgjedhor. Për rastet përjashtimore të pikës 5 dhe 6 të këtij neni, autoriteti dokumenton arsyetimin e plotë, njofton menjëherë KQZ-në dhe i nënshtrohet verifikimit të posaçëm.
8. Veprimi i prokurimit që përbën devijim të provuar zgjedhor ndalohet sipas fazës, pa cenuar kompetencat e organeve të prokurimit dhe mjetet ligjore të operatorëve ekonomikë.

Neni 91/14
Investimet dhe pasuria publike

1. Gjatë periudhës së mbrojtur zgjedhore ndalohet nisja, miratimi ose përfundimi i privatizimeve, koncesioneve, marrëveshjeve PPP, dhënieve afatgjata me qira ose në përdorim, transferimeve të pronësisë dhe akteve që krijojnë të drejta të reja zhvillimi mbi pasuri publike, me përjashtim të veprimeve objektivisht të domosdoshme për emergjenca reale, sigurinë ose vijimin e pandërprerë të shërbimeve esenciale. Përjashtimi kërkon arsye konkrete, pamundësi të shtyrjes, provë dokumentare dhe kontroll të menjëhershëm. Lejohet përmbushja e një detyrimi kontraktor të mëparshëm, pa vendimmarrje të re disponimi.
2. Për investimet publike verifikohen grafiku fillestar dhe i ndryshuar, urdhrat e përshpejtimit, punimet, situacionet, certifikimet dhe pagesat. Kur shfaqet ndryshim material i pajustifikuar dhe rrezik aktual i përfitimit zgjedhor, KQZ mund të pezullojë përkohësisht devijimin. Në rast pezullimi, autoriteti përgjegjës provon me dokumente arsyet objektive të ndryshimit. Kontraktimi i mëparshëm nuk e përjashton kontrollin e ekzekutimit.
3. Ceremonitë dhe promovimi publik i investimeve i nënshtrohen ndalimeve të posaçme për aktivitetet zyrtare, sipas parashikimeve të këtij Kodi.
4. Masat e lidhura funksionalisht vlerësohen në tërësinë e tyre, edhe kur ndahen ndërmjet disa autoriteteve, loteve, kontratave, shoqërive nën kontroll publik ose burimeve të financimit.
5. Nuk lejohet fragmentimi artificial për të shmangur kontrollin; as bashkimi artificial i projekteve realisht të pavarura për të rënduar përgjegjësinë.

Neni 91/15
Informacioni dhe verifikimi

1. Nënkomisioneri shtetëror i Zgjedhjeve monitoron ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, buxhetore dhe të kontratave publike vlerësuar në aspektin e ndikimit zgjedhor, nëpërmjet regjistrave dhe të dhënave ekzistuese të prokurimit, financave publike, kontratave e pagesave, si dhe dokumenteve që i kërkon institucioneve kompetente.
2. Për masat ekonomike me rëndësi zgjedhore, të nisura përpara periudhës së mbrojtur zgjedhore, institucionet publike kanë detyrimin të paraqesin në KQZ, brenda shtatë ditëve nga fillimi i periudhës së mbrojtur saj, të dhënat bazë mbi financimin, objektin, territorin, fazën e realizimit dhe kalendarin e planifikuar, nëpërmjet dokumenteve apo

regjistrave ekzistues. Ndryshimet materiale njoftohen pa vonesë me arsyetimin përkatës. Për informacionin e klasifikuar përdoren kanale të sigurta sipas legjislacionit përkatës.
3. Paraqitja ose publikimi i informacionit nuk konsiderohet miratim paraprak apo prezumim ligjshmërie. KQZ-ja i trajton dhe administron të dhënat e depozituara sipas parashikimeve ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin tregtar dhe informacionin e klasifikuar.
4. Përdorimi i një procedure të klasifikuar, konfidenciale ose të përjashtuar nga publikimi nuk e përjashton kontrollin zgjedhor. Institucioni Publik ka detyrimin të vërë në dispozicion, përmes kanaleve të sigurta dhe në përputhje me regjimin ligjor të sekretit, informacionin e domosdoshëm për verifikim. Fshehja me dashje ose klasifikimi i përdorur për të shmangur kontrollin përbën rrethanë rënduese të kundërvajtjes përkatëse, kur provohet. Nuk kërkohet publikimi i sekretit të mbrojtur me ligj.
5. Verifikimi i posaçëm aktivizohet nga indicie konkrete ose nga tregues si ndryshimi material i vlerës, burimit të financimit, territorit a kalendarit; procedura e përshpejtuar; ndryshimi jashtë veprimtarisë së zakonshme i kontratës; përshpejtimi i punimeve; ose fragmentimi i lidhur.
6. Ekzistenca e një rrethane sipas pikës 5 krijon bazë për verifikim, por jo konstatim të menjëhershëm të shkeljes. Kur rrethana shoqërohet me rrezik konkret dhe aktual të materializimit të përfitimit zgjedhor, KQZ mund të vendosë pezullim të përkohshëm, të kufizuar në veprimin e dyshuar. Autoriteti publik paraqet menjëherë dokumentet që provojnë domosdoshmërinë, shkaqet objektive dhe mungesën e alternativave më pak kufizuese. Vendimi për ndëshkim kërkon provim të veçantë të elementeve të shkeljes dhe të fajësisë.
7. KQZ-ja mund të veprojë kryesisht ose mbi njoftim të dokumentuar të qytetarëve, organizatave, subjekteve zgjedhore dhe institucioneve kompetente.

Neni 91/16
Masat parandaluese dhe detyrimet e zbatimit

1. Kur ka indicie konkrete dhe rrezik aktual për shkelje të këtij seksioni, Nënkomisioneri vendos me akt të arsyetuar masën e pezullimit për ndalimin e devijimit zgjedhor. Për kohëzgjatjen, dëgjimin dhe rishqyrtimin zbatohen garancitë e nenit 91/31.
2. Vendimi i pezullimit, i mbështetur drejtpërdrejt në këtë nen, përcakton fazën, veprimin dhe kohëzgjatjen e ndalimit: mosnisjen e procedurës së ndaluar; pezullimin e shpalljes, vlerësimit ose lidhjes së kontratës; ndalimin e urdhrit të përshpejtimit ose të ndryshimit të grafikut; pezullimin e certifikimit të veprimit të ndaluar; ose pezullimin e urdhërimit dhe ekzekutimit të pagesës që lidhet vetëm me këtë veprim. Vendimi është i detyrueshëm për autoritetin kontraktor, urdhëruesin, certifikuesin dhe organin financiar brenda kompetencave të tyre. Nuk pezullohen pagesat e maturuara për detyrime të ligjshme ndaj palëve në mirëbesim.
3. Për masën urgjente, Nënkomisioneri vendos jo më vonë se 24 orë nga marrja e kërkesës ose dokumentimi kryesisht i indicieve. Vendimi arsyetohet dhe njoftohet

menjëherë; subjekti dëgjohet përpara vendimit kur është e mundur, ose jo më vonë se 24 orë pas tij. Masa rishqyrtohet brenda 24 orëve nga seanca e shqyrtimit.
4. Ankesa ndaj masës ose ndaj mosveprimit, paraqitet në KAS brenda 24 orëve nga njoftimi ose mbarimi i afatit të vendimmarrjes nga Nënkomisioneri;
5. KAS-i merr vendim për pranimin, ose refuzimin e ankimit brenda 48 orëve nga regjistrimi i ankesës.
6. Ankimi gjyqësor paraqitet brenda 48 orëve nga vendimi i KAS-it dhe gjykata kompetente vendos brenda 5 ditëve nga regjistrimi, sipas dispozitave të këtij Kodi.
7. Deri në marrjen e vendimit gjyqësor Autoriteti kontraktor, urdhëruesi, mbikëqyrësi, certifikuesi dhe autoriteti financiar, secili brenda kompetencës, kanë detyrimin të mos ekzekutojnë dhe vijojnë fazën e ndaluar nga vendimi i ekzekutueshëm.
8. Ndalohet përdorimi i certifikimit, marrjes në dorëzim ose pagesës për të shmangur një masë të ligjshme ndalimi.
9. KQZ-ja në ushtrimin e kompetencave sipas këtij Kodi nuk zëvendëson autoritetin kontraktor, organin e ankimit në prokurime, thesarin ose gjykatën në kompetencat e tyre sektoriale. Vendimet e ekzekutueshme të KQZ-së, të nxjerra në bazë të ligjit, janë detyruese për organet që duhet t'i zbatojnë.

Neni 91/17
Përgjegjësia për shkeljet ekonomike

1. Për shkeljet ekonomike me ndikim zgjedhor, do të zbatohen rregullat e ligjeve sektoriale për kthimin e fondeve, përgjegjësinë financiare, si dhe pavlefshmërinë dhe kompensimin. Shkeljet ekonomike me ndikim zgjedhor nuk sjellin automatikisht pavlefshmërinë e kontratës ose humbjen e pagesës së maturuar për operatorin në mirëbesim. Ato vlerësohen rast pas rasti duke marrë në konsideratë vlerën, rëndësinë e shkeljes, përsëritjen dhe pasojat që ka sjellë.
2. Përgjegjësia lidhur me shkeljen zgjedhore është individuale dhe nuk lind vetëm nga pozicioni hierarkik. Ajo lidhet me rolin e çdo anëtari të organi kolegjial apo strukture shtetërore duke evidentuar urdhëruesin, propozuesin, miratuesin, certifikuesin, ekzektuesin, e aktit apo veprimit që konsiderohet shkelje zgjedhore.
3. Kur ka indicie për vepër penale, Nënkomisioneri referon menjëherë shkeljen në Organin e Prokurorisë. Procedimi administrativ nuk përdoret për të penguar ose vonuar ndjekjen penale. Kur dy procedime lidhur me të njëjtat fakte kanë natyrë ndëshkuese, organet kompetente sigurojnë për aq sa lejon ligji, lidhje të ngushtë materiale e kohore, qëllime plotësuese, shkëmbim provash dhe proporcionalitet të barrës së përgjithshme. Sanksioni i vendosur më parë merret parasysh në vlerësimin e sanksionit të mëvonshëm. Nëse kushtet e bashkërendimit mungojnë dhe ruajtja e gjobës administrative shkel ndalimin e ndëshkimit të dyfishtë, rishikimi ose shfuqizimi i saj bëhet nga organi kompetent, sipas procedurës dhe mjeteve ligjore të ankimit.
4. Organizimi, urdhërimi ose zbatimi me faj i një veprimi të ndaluar nga nenet 91/11, 91/13 dhe 91/14 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë për personin përgjegjës. Lidhja zgjedhore provohet kur kërkohet si element i ndalimit përkatës. Për ndalimin kategorik të nenit 91/14, pika 2, nuk kërkohet të provohet qëllimi subjektiv zgjedhor; fajësia e personit provohet në çdo rast.

5. Mosdhënia me faj e të dhënave të detyrueshme ose paraqitja materialisht e pasaktë e tyre dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 100 000 lekë; moszbatimi me dashje i vendimit të ekzekutueshëm parandalues dënohet me gjobë nga 200 000 deri në 1 000 000 lekë, përveç kur përbën vepër penale.
6. Gjoba caktohet sipas rëndësisë së veprimit, rolit, fondeve të përfshira, kohëzgjatjes, përsëritjes dhe masave për shmangien e pasojës. Shmangia e qëllimshme e raportimit ose kontrollit përmes procedurave të klasifikuara, sekrete apo të përjashtuara nga publikimi përbën rrethanë rënduese kur provohet. Një episod faktik nuk copëzohet artificialisht për shumëfishim gjobash. Shkeljet e së njëjtës natyrë në episode faktikisht të veçanta ndëshkohen veçmas.
7. Për procedimet administrative dhe penale që lidhen me të njëjtat fakte zbatohen garancitë e nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së dhe kriteret e lidhjes materiale e kohore të përcaktuara në nenin 91/17, pika 3. Në rast papajtueshmërie të kumulimit me këto garanci, shqyrtimi i gjobës administrative kryhet nga organi dhe sipas mjetit procedural të parashikuar me ligj.

SEKSIONI V
PATRONAZHIMI POLITIKO-ADMINISTRATIV

Neni 91/18
Ndalimi i patronazhimit politiko-administrativ

1. Patronazhimi politiko-administrativ është ndalim i përhershëm.
2. Patronazhim politiko-administrativ është organizimi, drejtimi, koordinimi, kryerja ose përdorimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i veprimeve që lidhin interesin politik me ushtrimin e funksionit publik, veprimtarinë shtetërore ose marrëdhënien e personit me administratën publike, me qëllim sigurimin e një përfitimi politik ose zgjedhor, krijimin ose ruajtjen e varësisë politike, ose ndikimin mbi lirinë e formimit të vullnetit politik ose zgjedhor.
3. Përbën patronazhim politiko-administrativ, sipas pikës 2 të këtij neni:
a) mbledhja, marrja, nxjerrja, përpunimi, kombinimi, ruajtja, transferimi ose përdorimi për qëllime politike i të dhënave shtetërore jopublike për profilizimin politik të personave;
b) përdorimi për qëllime politike i informacionit mbi nevojën, varësinë ose interesin e personit në marrëdhëniet me administratën publike;
c) krijimi ose përdorimi i një kanali politik, jashtë kanaleve zyrtare të aksesueshme në kushte të barabarta, për paraqitjen, përcjelljen, ndjekjen, prioritizimin, përshpejtimin ose zgjidhjen e kërkesave për akte, shërbime, të drejta ose përfitime administrative;
ç) ndërhyrja, për shkak të interesit politik, në radhën, afatin, prioritetin, kriteret ose mënyrën normale të trajtimit të një procedure administrative;
d) ofrimi, premtimi, ndërmjetësimi, përshpejtimi ose realizimi i një akti, shërbimi, të drejte ose përfitimi administrativ, duke e lidhur atë me mbështetjen politike ose sjelljen zgjedhore të personit;

dh) vonimi, pengimi, refuzimi ose kërcënimi me humbjen e një akti, shërbimi, të drejte ose përfitimi administrativ për shkak të bindjes, mbështetjes ose mosmbështetjes politike, ose për të ndikuar sjelljen politike apo zgjedhore;
e) paraqitja e një akti, shërbimi, të drejte ose përfitimi që buron nga ligji si favor i një partie politike, subjekti zgjedhor, kandidati, funksionari publik ose personi që vepron për llogari apo në interes të tyre;
ë) rekrutimi, caktimi, ndarja territoriale ose funksionale, drejtimi ose koordinimi i personave për kryerjen e veprimeve të parashikuara në këtë nen;
g) kërkimi, urdhërimi, organizimi ose ushtrimi i presionit ndaj punonjësit ose funksionarit publik për të identifikuar, regjistruar, profilizuar, kontaktuar, rekrutuar ose ndikuar persona të tjerë, për shkak të lidhjeve familjare, shoqërore, profesionale, të varësisë ose të interesit, për qëllime politike ose zgjedhore;
gj) caktimi i punonjësve publikë si përgjegjës për persona ose grupe personash dhe kërkimi prej tyre i informacionit ose raportimit për bindjen, mbështetjen, pjesëmarrjen, mospjesëmarrjen ose sjelljen e pritshme zgjedhore të këtyre personave;
h) kushtëzimi i punësimit, vazhdimit të marrëdhënies së punës, rinovimit të kontratës, ngritjes në detyrë, emërimit, shpërblimit ose çdo përfitimi profesional me pjesëmarrjen në një rrjet patronazhimi, kryerjen e veprimtarisë politike ose zgjedhore, identifikimin apo rekrutimin e personave të tjerë, ose mbështetjen politike;
i) ofrimi, premtimi ose ndërmjetësimi i punësimit në administratën publike për personin ose persona të lidhur me të, me qëllim sigurimin e mbështetjes politike, rekrutimin në rrjet ose ndikimin mbi sjelljen zgjedhore;
j) krijimi, plotësimi ose përdorimi i vendeve të punës, përfshirë marrëdhëniet e përkohshme të punës, si pjesë e një mekanizmi të organizuar për rekrutimin politik ose zgjedhor;
k) kërkimi ose ushtrimi i presionit ndaj personit për të votuar në favor të një subjekti ose kandidati, për të mos votuar në favor të një subjekti ose kandidati tjetër, ose për të mos marrë pjesë në votim, duke përdorur marrëdhënien e punës, varësinë hierarkike, mundësinë e punësimit ose një interes tjetër të lidhur me administratën publike.
l) fshehja, fshirja, mosregjistrimi, ndryshimi, falsifikimi ose shmangia me dashje e gjurmës shkresore ose elektronike të ndërhyrjes politike në procedurën administrative.
4. Nuk përbën patronazhim vetëm përdorimi, për qëllime të ligjshme politike ose zgjedhore, i të dhënave që ligji i përcakton si publike. Përdorimi i tyre përbën patronazhim kur ato lidhen ose kombinohen me të dhëna shtetërore jopublike ose përdoren për të ndërhyrë politikisht në marrëdhënien e personit me administratën publike, sipas këtij neni.
5. Për ekzistencën e shkeljes nuk kërkohet që të kryhen të gjitha veprimet e parashikuara në pikën 3. Veprimet e lidhura vlerësohen në tërësinë e tyre kur, sipas rrethanave, përbëjnë pjesë të të njëjtit mekanizëm patronazhimi.
6. Për veprimet që synojnë ndikimin mbi sjelljen zgjedhore nuk kërkohet të provohet se personi votoi, nuk votoi ose votoi në mënyrën e kërkuar. Shkelja konsumohet me kryerjen e veprimit të ndaluar, pa cenuar fshehtësinë e votës.

7. Kryerja e patronazhimit politiko-administrativ në lidhje me zgjedhjet, gjatë periudhës së mbrojtur nga ky Kod ose me qëllim sigurimin e një avantazhi zgjedhor përbën rrethanë rënduese.

Neni 91/19
Vlerësimi dhe përgjegjësia për patronazhimin

1. Për konstatimin e shkeljeve të parashikuara në nenin 91/18 vlerësohen të gjitha rrethanat e rastit dhe, sipas rastit, burimi dhe natyra e të dhënave, mënyra e sigurimit dhe përdorimit të tyre, ekzistenca e profilizimit politik, lidhja ndërmjet strukturës politike dhe administratës publike, ndërhyrja në procedurën administrative, devijimi nga radha ose afatet e zakonshme, ndryshimi i grafikut të zbatimit ose intensitetit të trajtimit, përsëritja, numri i personave të përfshirë, përqendrimi në kohë ose territor, komunikimet ndërmjet personave të përfshirë dhe veprimet për fshehjen ose manipulimin e gjurmëve.
2. Rritja e numrit ose ritmit të akteve, shërbimeve ose përfitimeve administrative nuk përbën, në vetvete, provë të patronazhimit. Ajo mund të vlerësohet si indicie kur shoqërohet me rrethana të tjera që tregojnë ndërhyrje ose selektivitet politik.
3. Ligjshmëria materiale e aktit ose ekzistenca e së drejtës së personit nuk përjashton shkeljen kur provohet se ndërhyrja politike ka ndryshuar radhën, afatin, prioritetin, mënyrën e trajtimit ose është përdorur për përvetësimin politik të rezultatit administrativ.
4. Për shkeljet e parashikuara në nenin 91/18 përgjigjet çdo person që, me dashje, urdhëron, organizon, drejton, koordinon, ndërmjetëson, kryen ose ndihmon kryerjen e patronazhimit politik-administrativ.
5. Punonjësi ose funksionari publik përgjigjet kur, duke ditur natyrën politike të ndërhyrjes, e pranon ose e zbaton atë, ndryshon trajtimin normal të çështjes ose mundëson përdorimin politik të funksionit, informacionit, shërbimit ose kompetencës publike.
6. Personi që nuk është punonjës ose funksionar publik përgjigjet për veprimet e veta sipas këtij Kodi dhe, kur plotësohen kushtet e ligjit, i nënshtrohet edhe ndalimit për t'u punësuar apo emëruar në administratën publike.
7. Përgjegjësia individualizohet sipas rolit, shkallës së dijenisë, dashjes, përsëritjes, pasojës dhe rolit organizues ose drejtues.
8. Kur personi provon se është përfshirë në skemë nën kërcënimin ose presionin ndaj vendit të tij të punës, karrierës, kontratës ose punësimit të një familjari apo personi të lidhur me të, kjo rrethanë merret parasysh në individualizimin e përgjegjësisë. Raportimi me mirëbesim i skemës dhe bashkëpunimi për sigurimin e provës mbrohen nga hakmarrja administrative.
9. Rëndojnë përgjegjësinë administrative:
a) kryerja e shkeljes në lidhje me zgjedhjet ose gjatë periudhës së mbrojtur nga ky Kod;
b) organizimi, drejtimi, koordinimi ose përsëritja e shkeljes;
c) kryerja ndaj disa personave ose nëpërmjet disa institucioneve;
ç) përdorimi i pozitës drejtuese ose i vartësisë hierarkike;
d) përdorimi i të dhënave shtetërore jopublike;

dh) shfrytëzimi i nevojës, varësisë konkrete ose interesit të personit në marrëdhëniet me administratën;
e) kushtëzimi, kërcënimi, diskriminimi ose hakmarrja administrative;
ë) manipulimi i radhës, dokumentacionit ose gjurmës elektronike;
f) fshehja, ndryshimi ose shkatërrimi i provave.

Neni 91/20
Masat për patronazhimin

1. Shkeljet e këtij seksioni, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë sipas nenit 91/32 dhe, sipas rëndësisë së shkeljes, me masat e tjera të parashikuara në këtë Kod.
2. Për shkeljet e rënda mund të vendoset, krahas gjobës, largimi nga funksioni ose detyra, kur kjo masë lejohet nga legjislacioni që rregullon marrëdhënien përkatëse, si dhe ndalimi për të ushtruar funksion publik për një periudhë pesë vjeçare.
3. Për shkeljet shumë të rënda, të organizuara ose sistematike, ndalimi për të ushtruar funksion publik mund të caktohet deri në dhjetë vjet.
4. Kur shkelja kryhet nga person që nuk ushtron funksion publik, ndalimi sipas pikave 2 dhe 3 zbatohet për marrjen ose ushtrimin e një funksioni publik gjatë periudhës së caktuar.
5. Masa administrative nuk përjashton përgjegjësinë disiplinore, civile ose penale sipas legjislacionit në fuqi.
6. Kur nga faktet dalin të dhëna për kryerjen e një vepre penale, organi që konstaton shkeljen i referon ato menjëherë organit kompetent të ndjekjes penale.
7. Masa korrigjuese synon rivendosjen e trajtimit të barabartë dhe neutral. Anulimi i një akti që ka krijuar të drejta për një palë të tretë në mirëbesim bëhet vetëm kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji për vlefshmërinë dhe anulimin e akteve administrative.
8. Ndalimi për ushtrimin ose marrjen e funksionit publik vendoset nga KAS-i me vendim të posaçëm të arsyetuar, pas dëgjimit të personit dhe vlerësimit të rolit, dashjes, organizimit, shtrirjes dhe përsëritjes. Për formën shumë të rëndë afati deri në dhjetë vjet kërkon provimin e organizimit ose sistematikës dhe arsyetim të posaçëm të domosdoshmërisë. Vendimi ankimohet dhe ekzekutohet sipas nenit 91/33, pika 5. Për funksionet kushtetuese, mandatet e zgjedhura dhe ndalimin e kandidimit zbatohen Kushtetuta dhe legjislacioni i posaçëm; masa administrative nuk zëvendëson procedurën kushtetuese të mbarimit të mandatit.

SEKSIONI VI
KONTROLLET DHE INSPEKTIMET

Neni 91/21
Ndalimi i inspektimeve dhe kontrollit me motiv politik

1. Ndalohet në çdo kohë përdorimi, urdhërimi, organizimi ose drejtimi i një kontrolli, inspektimi, verifikimi, hetimi administrativ, masë sanksionuese, pezulluese, bllokuese, mbyllëse, ndërprerëse ose të një kompetence tjetër shtrënguese të një autoriteti publik

për shkak të bindjes, aktivitetit, mbështetjes, mosmbështetjes ose sjelljes politike të personit, subjektit ose personave të lidhur me të.
2. Ndalohet përdorimi i kompetencave të përcaktuara në pikën 1 për të ndikuar pjesëmarrjen ose mospjesëmarrjen në votim, mbështetjen e një subjekti zgjedhor ose kandidati, pjesëmarrjen në veprimtari politike, ose ushtrimin e lirë të të drejtave politike.
3. Ndalimi përfshin edhe mosushtrimin, shtyrjen ose tolerimin selektiv të kontrollit ose sanksionit kur kjo bëhet për të favorizuar politikisht një person, subjekt ose kategori personash.
4. Kryerja e veprimeve të parashikuara në këtë nen në lidhje me procesin zgjedhor, gjatë periudhës së mbrojtur zgjedhore, ose si realizim paszgjedhor i një kërcënimi apo kushtëzimi të bërë për qëllim zgjedhor, përbën rrethanë rënduese.
5. Ky nen nuk pengon kontrollet dhe masat e bazuara në ligj, në kritere objektive dhe të dokumentuara të riskut, si dhe ndërhyrjet e nevojshme për mbrojtjen e jetës, shëndetit, sigurisë, rendit publik, mjedisit, interesit fiskal ose një interesi tjetër publik të mbrojtur me ligj.
6. Për vlerësimin nëse kompetenca kontrolluese ose shtrënguese është përdorur për qëllim politik ose zgjedhor merren parasysh, sipas rastit, kriteret e përzgjedhjes së subjektit, baza e riskut, koha, shpeshtësia, intensiteti, proporcionaliteti i masës, trajtimi i subjekteve të krahasueshme, ndërhyrjet jashtë zinxhirit ligjor të vendimmarrjes dhe lidhja kohore ose funksionale me veprimtarinë politike apo zgjedhore.
7. Ndryshimi i grafikut, rritja e numrit të kontrolleve ose përqendrimi territorial nuk përbëjnë në vetvete provë të shkeljes, por mund të përbëjnë indicie për fillimin ose zgjerimin e verifikimit.
8. Fakti që autoriteti ka kompetencë ligjore për të kryer kontrollin ose për të vendosur masën nuk përjashton shkeljen kur provohet se përzgjedhja, koha, intensiteti ose masa janë përcaktuar nga një qëllim politik ose zgjedhor.

Neni 91/22
Planifikimi i kontrolleve dhe përgjegjësia

1. Nga data e dekretimit të zgjedhjeve ose 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve, cilado periudhë që vjen më parë, autoritetet shtetërore që ushtrojnë kompetenca kontrolluese ose inspektuese miratojnë planin e kontrolleve që do të kryhen deri në tre muaj pas datës së zgjedhjeve. Plani mbështetet në periodicitetin ligjor ose normal të kontrollit dhe në kritere objektive e të dokumentuara risku. Kur natyra e kontrollit e lejon, plani identifikon subjektet që do t'i nënshtrohen kontrollit.
2. Kriteret, metodologjia dhe të dhënat e planit të kontrollit bëhen publike. Lista e subjekteve të planifikuara regjistrohet përpara fillimit të periudhës dhe, kur publikimi i saj cenon efektivitetin e kontrollit ose të dhëna të mbrojtura, vihet vetëm në dispozicion të KQZ. Njoftimi paraprak i subjektit bëhet sipas legjislacionit sektorial dhe vetëm kur nuk cenon qëllimin e kontrollit.
3. Pas miratimit, çdo ndryshim i planit duhet të jetë i arsyetuar dhe të ruajë gjurmën e versionit fillestar, datën, autorin dhe shkakun e ndryshimit.

4. Kontrolli i një subjekti që nuk është parashikuar në plan lejohet kur pas miratimit të tij lind një fakt, sinjalizim, detyrim ligjor ose risk i ri, objektiv dhe i dokumentuar. Shkaku dhe koha e aktivizimit regjistrohen përpara fillimit të kontrollit, përveç rasteve të urgjencës së provueshme.
5. Për verifikimin e një rasti konkret, Nënkomisioneri ka të drejtë të kërkojë informacion dhe të dhëna të nevojshme, pa ndërhyrë në drejtimin profesional të kontrollit dhe pa bërë publike të dhëna të mbrojtura me ligj.
6. Kur ekzistojnë indicie serioze se një kontroll po përdoret për qëllim politik ose zgjedhor dhe vazhdimi i tij mund të shkaktojë dëm të rëndë ose të vështirë për t'u riparuar, Nënkomisioneri mund të urdhërojë pezullimin e përkohshëm të veprimit të kontestuar deri në verifikimin e shpejtë të ligjshmërisë së tij. Pezullimi nuk zbatohet kur vonesa krijon rrezik serioz për jetën, shëndetin, sigurinë, rendin publik, mjedisin ose një interes tjetër publik të mbrojtur me ligj.
7. Në zgjedhjet e parakohshme ose të pjesshme, kur afati katërmujor nuk mund të respektohet për shkak të datës së dekretimit, plani paraqitet brenda shtatë ditëve nga dekreti. Deri atëherë zbatohen planet ekzistuese dhe dokumentohet veçmas çdo shkak i ri ose urgjencë.
8. Përgjegjësia individualizohet sipas rolit të urdhëruesit, organizatorit, ndërmjetësit, zbatuesit me dijeni dhe personit që ka fshehur, ndryshuar ose manipuluar gjurmën e vendimmarrjes.
9. Kur konstatohet shkelja, KAS-i me propozimin e Nënkomisionerit vendos sanksionin administrativ. Nënkomisioneri, sipas rastit, urdhëron ndalimin e veprimit abuziv, ose korrigjimin e pasojës së prodhuar nga selektiviteti politik, pa cenuar mbrojtjen e interesave publike që kërkojnë zbatim të menjëhershëm të ligjit.
10. Kur faktet krijojnë dyshim të arsyeshëm për vepër penale, materialet i referohen pa vonesë organit kompetent të ndjekjes penale. Përgjegjësia administrative nuk përjashton përgjegjësinë disiplinore, civile ose penale sipas ligjit.
11. Shkelja e ndalimeve të parashikuara në këtë nen, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë personale ndaj autorit. Masa e gjobës përcaktohet sipas nenit 91/32 dhe individualizohet sipas rolit, dashjes, pasojës, përsëritjes dhe numrit të personave ose subjekteve të prekur.
12. Përbëjnë shkelje të rëndë, përdorimi i zinxhirit hierarkik, koordinimi i dy ose më shumë strukturave, kërcënimi ose reprezalja, manipulimi i bazës së riskut ose i gjurmës së kontrollit, vendosja e një mase me pasoja të rënda ekonomike ose personale dhe kryerja e shkeljes për qëllim zgjedhor.
13. Për punonjësin ose funksionarin publik, sanksioni administrativ shoqërohet, sipas rëndësisë, me referim për masë disiplinore deri në largim nga detyra. Për urdhëruesin ose organizatorin e një skeme të përsëritur ose të bashkërenduar, KAS-i mund të vendosë edhe ndalimin e përkohshëm të ushtrimit të funksionit publik, sipas kushteve dhe afateve të nenit 91/20.
14. Subjekti politik ose kandidati që ka kërkuar, organizuar ose ka përfituar me dijeni nga keqpërdorimi i pushtetit kontrollues i nënshtrohet sanksioneve të nenit 172, sipas kushteve të tij.

SEKSIONI VII
TË DHËNAT DHE LIRIA E VOTËS

Neni 91/23
Mbrojtja e të dhënave dhe lirisë së votës

1. Të dhënat personale të administruara për qëllime zgjedhore përpunohen vetëm për qëllime të përcaktuara me ligj, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, kufizimit të qëllimit, minimizimit, sigurisë dhe përgjegjshmërisë. Përdorimi i të dhënave personale për qëllime zgjedhore ndalohet në mënyrë të përhershme.
2. Ndalohet mbledhja, kopjimi, regjistrimi, bashkimi, transmetimi ose përdorimi sistematik i të dhënave që identifikojnë pjesëmarrjen ose mospjesëmarrjen individuale në votim, kur synohet profilizimi politik, kontrolli i sjelljes së zgjedhësit, ushtrimi i presionit ose kushtëzimi i tij.
3. Ndalohet përdorimi për qëllimet e pikës 2 i të dhënave personale të zgjedhësit të marrë gjatë procesit të votimit, përfshirë raportimin përmes aplikacioneve ose sistemeve të tjera të komunikimit.
4. Ndalohet kërkimi, kontrolli, dokumentimi ose verifikimi i shenjës së pjesëmarrjes në votim nga çdo person jashtë procedurës së parashikuar shprehimisht në ligj, me përjashtim të procedurave të parashikuara në ligji për identifikimin e zgjedhësit në qendrën e votimit.
5. Dispozitat e këtij neni nuk kufizojnë administrimin e ligjshëm të votimit, aksesin e zgjedhësit në të dhënat e veta, vëzhgimin e ligjshëm, hetimin, auditimin e pavarur dhe aksesin e kontrolluar të subjekteve të autorizuara për ankime zgjedhore.
6. Nënkomisioneri merr masa për ndërprerjen e shkeljeve brenda kompetencës së tij dhe njofton pa vonesë autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale ose organin e ndjekjes penale, sipas rastit. Nënkomisioneri ka detyrimin të administrojë në cilësinë e provës bazën e të dhënave, aplikacioneve ose mjeteve të barasvlershme me to, duke i trajtuar dhe asgjësuar sipas procedurave ligjore përkatëse.
7. Ndalohet zotërimi, administrimi, mirëmbajtja, vënia në dispozicion dhe përdorimi i bazave të të dhënave, aplikacioneve ose mjeteve të barasvlershme që kanë për qëllim ose përdoren për profilizimin politik të paligjshëm, monitorimin individual të pjesëmarrjes në votim ose kontrollin e zgjedhësve.
8. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji ndalohet mbajtja, administrimi dhe përdorimi i instrumenteve të përcaktuara në pikën 7. Shkeljet sanksionohen sipas këtij Kodi, legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Kodit Penal, sipas rastit.
9. Ndalohet vënia në dispozicion të subjekteve politike apo kujtdo pale të tretë me qëllim kontaktimin, profilizimin apo mobilizimin individual politik e zgjedhor, të të dhënave të zgjedhësve brenda dhe jashtë vendit, të mbledhura dhe administruara në Platformat Elektronike Shtetërore, përfshirë edhe platformat elektronike të krijuara dhe administruara nga KQZ ose regjistra të tjerë publikë elektronikë. Publikimi ligjor i listës së zgjedhësve nuk autorizon përdorimin e saj për kontroll ose presion politik. Përjashtimet vlejnë vetëm kur parashikohen shprehimisht me ligj dhe për qëllimin e autorizuar.

10. Ndalohet detyrimi, kërcënimi, kushtëzimi ose kërkimi i provës së pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes së zgjedhësit në votim nga punëdhënësi, eprori, subjekti politik ose çdo person tjetër.
11. Ndalohet përdorimi i informacionit mbi pjesëmarrjen ose mospjesëmarrjen për të dhënë, refuzuar ose ndryshuar punësim, përfitim, shërbim, vendim administrativ ose masë kontrolli. Këtu përfshihet edhe presioni i tërthortë përmes punëdhënësit privat, kur nxitet ose mbështetet në ushtrimin apo kërcënimin e ushtrimit të kompetencave publike.
12. Mbrojtja sipas këtij neni zbatohet përherë, pa kufizim kohor, pavarësisht nëse presioni synon votimin apo abstenimin.

SEKSIONI VIII
VEPRIMTARITË ZYRTARE

Neni 91/24
Neutraliteti i veprimtarive zyrtare

1. Gjatë periudhës së mbrojtur zgjedhore, ushtrimi i funksioneve publike dhe veprimtaritë institucionale ndahen nga veprimtaria partiake e zgjedhore.
2. Ndalohet përdorimi i funksionit, autoritetit, prestigjit, personelit, mjeteve ose komunikimit institucional për të krijuar përfitim zgjedhor.
3. Zbatimi i këtij seksioni nuk pengon vijimin e shërbimeve dhe detyrimeve ligjore dhe nuk kufizon ushtrimin e të drejtave politike private, pa përdorim të burimeve shtetërore, pa cenuar kufizimet e përkohshme të seksionit II të këtij kreu.
4. Subjekt i ndalimeve të këtij neni janë Kryeministri, ministrat, zëvendësministrat, prefektët, kryetarët e bashkive, drejtuesit e institucioneve, agjencive dhe enteve publike, të shoqërive nën kontroll publik, si dhe të gjithë funksionarët publikë që veprojnë në cilësi zyrtare.
5. Përgjegjësia shtrihet edhe mbi organizatorët dhe subjektet e treta që veprojnë me kërkesë, financim, autorizim ose bashkërendim të provuar me subjektet e pikës 4, për veprime të lidhura me funksionin publik.
6. Ndalimet e këtij seksioni zbatohen nga data e dekretimit të zgjedhjeve, nëse ajo është më e hershme se katër muaj përpara votimit, ose, në rast të kundërt, nga fillimi i periudhës katërmujore, deri në përfundimin e votimit. Detyrimet ligjore që vazhdojnë pas votimit nuk preken.
7. Për zgjedhjet vendore dhe ato të pjesshme, ndalimet zbatohen në lidhje me procesin dhe territorin përkatës, përfshirë veprimtaritë e organeve qendrore me ndikim të drejtpërdrejtë në atë garë.

Neni 91/25
Veprimtaritë e ndaluara dhe komunikimi

1. Nga data e dekretimit të zgjedhjeve, nëse ajo është më e hershme se katër muaj përpara datës së votimit, e deri në datën e votimit ndalohen organizimi, financimi ose pjesëmarrja në cilësi zyrtare pavarësisht emërtimit apo organizatorit formal, në veprimtaritë dhe ceremonitë si vijon:

a) inaugurimet dhe ceremonitë e hapjes ose përfundimit të investimeve e objekteve publike;
b) ceremonitë promovuese për shpërndarje përfitimesh, grantesh ose shërbimesh;
c) prezantimet e arritjeve institucionale që personalizojnë përfitimin publik në funksion zgjedhor;
ç) vizitat dhe inspektimet e organizuara për promovim zgjedhor;
d) takimet me personelin ose përfituesit e shërbimeve publike për të kërkuar, nxitur apo demonstruar mbështetje politike;
dh) veprimtaritë e ndërmjetësuara nga palë të treta që realizojnë ndonjërin nga ndalimet e mësipërme me burime ose bashkërendim institucional.
2. Veprimtaritë e shkronjave "a" dhe "b" ndalohen për shkak të karakterit ceremonial-promovues të përcaktuar në ligj. Për shkronjat "c", "ç", "d" dhe "dh", karakteri zgjedhor vlerësohet nga përmbajtja, organizimi, financimi, koha, audienca, shpërndarja dhe lidhja me funksionin publik, të vlerësuara në tërësi; afërsia me votimin nuk përbën e vetme shkelje.
3. Vënia në përdorim e një investimi, kontrolli teknik dhe ofrimi i shërbimit publik lejohen pa ceremoni, personalizim politik dhe komunikim të ndaluar.
4. Rregullatori miraton me akt normativ shembuj ilustrues, tregues verifikimi dhe procedura raportimi për kategoritë e pikës 2. KQZ-ja nuk mund të shtojë kategori të reja ndalimi ose kundërvajtje përtej këtij Kodi.
5. Ndalohet përdorimi i faqeve dhe llogarive institucionale, reklamave të paguara me fonde publike, materialeve të prodhuara nga personeli shtetëror ose kanaleve të tjera zyrtare për promovimin e veprimtarive të ndaluara ose për propagandë zgjedhore.
6. Ndalimi zbatohet edhe për llogaritë personale të funksionarëve, kur publikimi përdor burime institucionale, është prodhuar ose administruar nga personeli publik, ose paraqet veprimtari të ndaluar si arritje personale e funksionarit.
7. Veprimtaritë e ndaluara me vendim të KQZ-së nuk transmetohen ose pasqyrohen nga transmetuesit radiotelevizivë në kushtet e nenit 92, pika 5, të këtij Kodi. Përmbajtja institucionale e porositur ose sponsorizuar në platforma të tjera i nënshtrohet ndalimeve të këtij seksioni.
8. Raportimi i pavarur gazetaresk, përfshirë mbulimin kritik dhe investigativ të një veprimtarie të dyshuar si të paligjshme, nuk ndalohet nga ky nen. Dallimi nga përmbajtja e porositur, financuar ose shpërndarë nën kontroll institucional bëhet mbi bazë provash.

Neni 91/26
Veprimtaritë e lejuara dhe njoftimi

1. Lejohen veprimtaritë objektivisht të domosdoshme për sigurinë, emergjencat, shëndetin publik, detyrimet ligjore me afat të pakapërcyeshëm dhe vazhdimësinë e shërbimeve publike.
2. Institucioni dokumenton nevojën, pamundësinë e shtyrjes dhe kufizimin e komunikimit në informacionin funksional. Në emergjencë dokumentimi kryhet menjëherë pas veprimit.

3. Përjashtimi nuk lejon ceremoni promovuese, reklamim politik ose përdorim zgjedhor të funksionit. Institucioni paraqet dokumentacionin shpjegues me kërkesë të Nënkomisionerit.
4. Brenda shtatë ditëve nga fillimi i periudhës së mbrojtur, institucionet depozitojnë në ndërfaqen elektronike të KQZ-së kalendarin paraprak të veprimtarive publike të njohura për të gjithë periudhën.
5. Çdo veprimtari e re ose e riplanifikuar regjistrohet jo më vonë se pesë ditë kalendarike përpara zhvillimit, me objektin, vendin, pjesëmarrësit institucionalë, burimin e financimit dhe planin e komunikimit. Ndryshimet materiale njoftohen menjëherë, duke shpjeguar shkakun. Nuk lejohet lënia me dashje jashtë kalendarit fillestar e një veprimtarie të njohur për ta raportuar më pas si veprimtari të re.
6. Për një veprimtari të domosdoshme që objektivisht nuk mund të parashikohet brenda afatit pesë ditor, njoftimi kryhet sapo ajo të bëhet e njohur dhe shoqërohet me arsyetim. Për emergjencat e menjëhershme, njoftimi kryhet brenda 24 orëve nga realizimi i veprimtarisë.
7. Raportimi nuk përbën miratim apo prezumim ligjshmërie. Nënkomisioneri monitoron kryesisht, përdor të dhënat e kalendarëve dhe pranon sinjalizime të dokumentuara.

Neni 91/27
Ndërprerja e veprimtarive të ndaluara

1. Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kryesisht ose kur ka indicie konkrete për veprimtari të ndaluar të afërt ose në zhvillim, vendos me akt të arsyetuar pezullimin e pjesës së ndaluar, ndërprerjen e veprimtarisë promovuese ose ndalimin e shpërndarjes institucionale të materialit të paligjshëm, sipas kompetencave të përcaktuara në këtë Kod.
2. Vendimi u komunikohet menjëherë institucionit dhe përgjegjësve të zbatimit. Në raste urgjente vendimi mund të merret pas verifikimit të përshpejtuar, duke garantuar dëgjimin dhe rishqyrtimin sa më parë.
3. Kundër vendimit ose mosveprimit mbi një kërkesë të dokumentuar sigurohet ankim administrativ dhe gjyqësor i përshpejtuar. Heshtja nuk përbën miratim. Masa parandaluese nuk përjashton ndëshkimin dhe zbatohet pa paralajmërim.
4. Veprimtaria e ndaluar dokumentohet veçmas sipas shpenzimeve të miratuara, kontraktimeve, faturimeve, certifikimeve dhe pagesave, me identifikimin e personit që ka urdhëruar ose autorizuar secilën fazë dhe konsiderohet e kryer nga partia politike ose subjekti zgjedhor përkatës.

Neni 91/28
Gjobat për veprimtaritë zyrtare

1. Organizimi, urdhërimi, financimi ose realizimi me dashje ose nga pakujdesia i veprimtarisë së ndaluar sipas nenit 91/25 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë për personin përgjegjës.
2. Mosparaqitja e kalendarit, mosraportimi i veprimtarisë ose dhënia me faj e të dhënave materialisht të pasakta dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 100 000 lekë.

Moszbatimi me dashje i urdhrit të ekzekutueshëm të ndërprerjes dënohet me gjobë nga 200 000 deri në 1 000 000 lekë.
3. Gjoba individualizohet sipas rolit, rëndësisë së funksionit, përdorimit të burimeve publike, kohëzgjatjes, përsëritjes, pasojës ose rrezikut të krijuar dhe veprimeve për shmangien e tij.
4. Për subjektin zgjedhor që përfiton nga shkelja zbatohet përgjegjësia sipas nenit 172 të Kodit, kur plotësohen kushtet e atij neni, pa prezumuar dijeninë apo bashkëpunimin e tij.
5. Kur disa kundërvajtje të dallueshme përbëjnë një episod të vetëm faktik kompleks, gjobat mund të vendosen veçmas, por shuma e tyre nuk tejkalon dyfishin e maksimumit ligjor të gjobës për kundërvajtjen më të rëndë të atij episodi.
6. Për identifikimin e episodit vlerësohen uniteti kohor, hapësinor, organizativ dhe funksional. Nuk lejohet copëzimi artificial i veprimtarisë për shumëfishimin e gjobave.
7. Kufiri i pikës 5 nuk zbatohet për episode faktikisht të pavarura, edhe kur janë të të njëjtit lloj. Ndalohet ndëshkimi i dyfishtë për të njëjtin fakt, në përputhje me ligjin dhe garancitë kushtetuese e konventore.
8. Gjobat nuk zëvendësojnë masat për ndërprerjen e veprimit të ndaluar dhe rivendosjen e ligjshmërisë.
9. Në rast të ndjekjes penale për të njëjtat fakte, autoritetet zbatojnë rregullat e bashkërendimit të procedimeve, pa krijuar kompetencë të re të gjykatës penale për shfuqizim automatik të vendimit administrativ.

Neni 91/29
Funksionarët kandidatë

1. Detyrimi për dorëheqje dhe papajtueshmëritë e kandidimit për deputet sipas nenit 69 të Kushtetutës zbatohen përparësisht dhe nuk mund të zëvendësohen me pezullim.
2. Për funksionarët e emëruar që nuk u nënshtrohen papajtueshmërive kushtetuese, kufizimi i kompetencave ose pezullimi gjatë kandidimit mund të parashikohet vetëm shprehimisht në ligjin që rregullon statusin e tyre, me përcaktim të kategorive, zëvendësimit, periudhës dhe të drejtave të rikthimit.
3. Kandidimi i Kryeministrit ose i ministrit nuk sjell pezullim automatik të funksionit. Për këta funksionarë zbatohen ndalimet e këtij seksioni dhe rregullat kushtetuese të emërimit, zëvendësimit e shkarkimit.

SEKSIONI IX
KONTROLLI DHE SANKSIONET

Neni 91/30
Regjistri dhe nëpunësi ndërlidhës

1. KQZ-ja administron Regjistrin Elektronik të Kontrollit të Neutralitetit Zgjedhor. Regjistri përmban identifikuesin unik të masës, formularin, projektin, versionet, ndryshimet, autorët, vulën kohore, dokumentet, vendimet, ankimet dhe statusin e ekzekutimit.

2. Versionet e mëparshme dhe gjurma e veprimeve ruhen të pandryshueshme. Sistemi mundëson krahasimin e versioneve dhe njofton drejtpërdrejt shkallët dhe nivelin e procedimit, botimit dhe ekzekutimit për vendimin e kontrollit.
3. Publikohen pa vonesë projekti, formulari, ndryshimet, statusi dhe vendimet, duke mbrojtur të dhënat personale, sekretin tregtar dhe informacionin e klasifikuar. Qasja e plotë u jepet vetëm personave të autorizuar për qëllimin ligjor.
4. Mungesa ose mosfunksionimi i sistemit nuk pezullon ndalimet, raportimin, kontrollin ose ankimin. Përdoret shkresa ose komunikimi elektronik institucional, me identifikim të dërguesit, datë të dërgimit e marrjes, integritet dhe gjurmueshmëri.
5. Çdo institucion cakton një nëpunës ndërlidhës për neutralitetin zgjedhor nga personeli profesional juridik ose administrativ.
6. Ndërlidhësi identifikon masat, kërkon të dhënat, administron formularin, regjistron versionet, ruan dokumentet dhe raporton pengimin ose shmangien.
7. Ai i drejtohet drejtpërdrejt Nënkomisionerit pa autorizim të titullarit. Titullari nuk mund të urdhërojë ndryshimin e të dhënave, mosraportimin ose vonesën. Për këto veprime përgjegjësia individualizohet veçmas.
8. Mungesa ose mosveprimi i ndërlidhësit nuk përligj masën, nuk pengon kontrollin kryesisht dhe nuk përjashton përgjegjësinë e vendimmarrësit ose ekzekutuesit.

Neni 91/31
Kontrolli dhe masat e përkohshme

1. Kontrolli fillon kryesisht ose mbi kërkesë të ndërlidhësit, subjektit zgjedhor, kandidatit, organit publik, grupit parlamentar, një të tretës së komisionit përgjegjës ose personit që provon interes të ligjshëm. Çdo qytetar ose organizatë mund të paraqesë indicie të dokumentuara.
2. Kërkesa regjistrohet menjëherë dhe nuk kërkon ndërmjetësimin e Komisionerit. Nënkomisioneri siguron provën, kërkon shpjegime dhe dëgjon personat e interesuar. Informacioni i kërkuar jepet brenda njëzet e katër orëve, përveç pamundësisë objektive të arsyetuar.
3. Për masën urgjente vendoset brenda njëzet e katër orëve nga kërkesa ose dokumentimi kryesisht i indicieve. Për kontrollin paraprak të masës normative vendoset brenda shtatëdhjetë e dy orëve nga marrja e dokumentacionit të plotë. Vendimi përfundimtar i hetimit administrativ merret brenda dhjetë ditëve; për arsye të dokumentuara ky afat zgjatet vetëm një herë deri në pesë ditë, pa cenuar afatet e masës urgjente.
4. Kërkesa nuk pezullon vetvetiu veprimin, përveç pasojës procedurale parlamentare të përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit. Heshtja nuk përbën miratim dhe nuk shëron ndalimin ligjor.
5. Vendimi identifikon faktet, bazën, masën, personat, fazën, objektin, kohëzgjatjen dhe ankimin. Ai njoftohet menjëherë dhe publikohet me kufizimet ligjore.
6. Kur ka indicie konkrete, urgjencë dhe rrezik aktual dëmi të rëndë ose të vështirë për t'u riparuar, Nënkomisioneri vendos masë të përkohshme të nevojshme, të kthyeshme dhe proporcionale: ndërprerje veprimtarie, tërheqje personeli a mjetesh, ndalim devijimi, kufizim aksesi ose transmetimi të paligjshëm, ruajtje dokumentesh e

regjistrash elektronikë ose pezullim të veprimit administrativ të kontestuar brenda kompetencës ligjore.
7. Masa kufizohet në pjesën e ndaluar dhe në kohëzgjatjen e domosdoshme, jo më shumë se shtatëdhjetë e dy orë pa rishqyrtim. Personi dëgjohet përpara saj kur është e mundur, ose brenda njëzet e katër orëve pas marrjes. Masa rishqyrtohet brenda njëzet e katër orëve nga dëgjimi. Çdo lejim, arsyetohet veçmas dhe përfundon jo më vonë se vendimi përfundimtar i kontrollit.
8. Nuk pezullohet ndërhyrja e domosdoshme për jetën, shëndetin, sigurinë, rendin, mjedisin ose një interes tjetër të fortë publik. Hiqet vetëm komponenti abuziv, kur është i ndashëm.
9. Pas konstatimit urdhërohet korrigjimi i komunikimit, heqja e materialit nën kontroll institucional, ndërprerja e skemës, rishqyrtimi i paanshëm dhe kthimi i avantazhit sipas ligjit. Vlefshmëria e akteve dhe të drejtat e palëve në mirëbesim trajtohen nga organi kompetent sipas legjislacionit përkatës.
10. Ruajtja dhe administrimi i provave, kryhet duke respektuar kuadrin ligjor përkatës. Nuk krijohet detyrim i përgjithshëm për arkivimin e sistemeve të ndaluara.
11. Masa parandaluese nuk përjashton ndëshkimin dhe zbatohet pa paralajmërim.

Neni 91/32
Kundërvajtjet dhe gjobat

1. Shkeljet e ndalimit të përdorimit politik të burimeve publike sipas nenit 91, të mobilizimit institucional sipas nenit 91/4, pikat 1-4 dhe të neneve 91/7–91/10, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga pesë deri në dhjetë paga mujore bruto të personit përgjegjës, por jo më pak se 100 000 lekë. Për ekzekutimin me dashje pas njoftimit të ndalimit, organizimin e skemës ose materializimin e përfitimit të ndaluar, gjoba është nga dhjetë deri në njëzet paga mujore bruto, por jo më pak se 200 000 lekë.
2. Patronazhimi politiko – administrativ dhe përdorimi politik i pushtetit kontrollues dënohen me gjobë nga pesë deri në dhjetë paga mujore bruto, por jo më pak se 100 000 lekë. Kur ka presion, kushtëzim, përsëritje, organizim, sistematikë, përfshirje të disa institucioneve ose përdorim i të dhënave shtetërore jopublike, gjoba është nga dhjetë deri në njëzet paga mujore bruto, por jo më pak se 200 000 lekë. Kur personi përgjegjës është i punësuar në sektorin privat, si pagë referuese merret paga bruto e muajit të fundit të marrëdhënies së punës; në mungesë të saj, paga mesatare bruto kombëtare e publikuar nga INSTAT për vitin paraardhës.
3. Mosraportimi, fshehja ose paraqitja me faj e të dhënave materialisht të pasakta dënohen me gjobë nga 100 000 lekë deri në 200 000 lekë; pengimi me dashje i kontrollit ose moszbatimi i vendimit të ekzekutueshëm kur nuk përbëjnë vepër penale dënohen me gjobë nga 200 000 deri në 1 000 000 lekë.
4. Për shkeljet ekonomike dhe veprimtaritë zyrtare zbatohen masat dhe sanksionet e posaçme të neneve 91/17 dhe 91/28. Për shkeljet e të dhënave sipas nenit 91/23, që nuk sanksionohen nga legjislacioni i mbrojtjes së të dhënave për të njëjtin fakt e interes, zbatohet gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë; për formën e organizuar ose të përsëritur zbatohen sanksionet e pikës 2 të këtij neni.

5. Personat përgjegjës për shkeljen e pikës 1 të nenit 91/5, dënohen me gjobë nga një deri në tri paga mujore bruto.
6. KAS-i merr vendim mbi propozimin e Nënkomisionerit, jo më vonë se dhjetë ditë nga depozitimi i kërkesës/propozimit. Në masën e gjobës evidentohen dhe merren në konsideratë roli, fajësia, autoriteti, shtrirja, kohëzgjatja, pasoja, fshehja e të dhënave apo fakteve e provave, si dhe veprimet korrigjuese. Gjoba është individuale për zyrtarin dhe jo për Institucionin.
7. Gjoba nuk zëvendëson kthimin e përfitimit. Gjobat për të njëjtin fakt nuk shumëfishohen nëpërmjet zbatimit paralel të dispozitave të përgjithshme e të posaçme.
8. Për llogaritjen e çdo gjobe të shprehur në paga sipas këtij kreu merret paga mujore bruto e personit në kohën e shkeljes. Për personin pa pagë publike merret paga bruto e muajit të fundit të marrëdhënies së punës; në mungesë të saj, paga mesatare bruto kombëtare e publikuar nga INSTAT-i për vitin paraardhës.

Neni 91/33
Ankimi dhe mosveprimi

1. Personi i prekur, organi publik, subjekti zgjedhor, kandidati dhe kërkuesi me interes të ligjshëm mund të ankimojnë masën urgjente ose mosmarrjen e saj nga Nënkomisioneri, pranë KAS brenda njëzet e katër orëve nga njoftimi ose mbarimi i afatit ligjor për marrjen e masës ose vednimit përkatës. KAS-i vendos brenda dyzet e tetë orëve nga regjistrimi i ankesës.
2. Vendimet e tjera të kontrollit ose mosveprimi për to nga ana e Nënkomisionerit, ankimohen në KAS brenda tri ditëve. KAS-i vendos brenda pesë ditëve. Kur Nënkomisioneri ka kaluar afatin, KAS-i vendos drejtpërdrejt mbi themelin dhe nuk e kthen çështjen për rishqyrtim.
3. Kundër vendimit ose mosveprimit të KAS-it paraqitet padi në Kolegjin Zgjedhor brenda dyzet e tetë orëve nga njoftimi ose mbarimi i afatit të vendimmarrjes. Kolegji vendos brenda shtatëdhjetë e dy orëve nga regjistrimi. Këto afate zbatohen edhe jashtë periudhës zgjedhore për çështjet e këtij kreu dhe për vendimet sanksionuese.
4.Ankimi nuk pezullon automatikisht masën parandaluese. Organi i ankimit mund ta pezullojë me vendim të arsyetuar. Për ndalimin shumëvjeçar të ushtrimit të funksionit publik, ekzekutimi fillon pas përfundimit të kontrollit gjyqësor ose pas kalimit të afatit të paraqitjes së padisë.
5. Për sa nuk parashikohet në këtë nen zbatohen rregullat e pjesëve X dhe XI. Juridiksioni i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor për çështjet e këtij kreu përfshin edhe ankimet e punonjësve, autoriteteve publike dhe palëve të treta të prekura drejtpërdrejt, pa përfshirë shfuqizimin e ligjeve ose zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjeve kontraktore dhe të marrëdhënieve të punës, që u përkasin juridiksioneve përkatëse.

Neni 91/34
Kthimi i përfitimit dhe bashkërendimi i procedimeve

1. Urdhëruesi, certifikuesi, organi financiar dhe Thesari, brenda kompetencës së tyre, nuk vijojnë apo ekzekutojnë fazën e ndaluar nga ligji dhe vendimi i ekzekutueshëm. Ruhen gjurma e urdhërimit, kontraktimit, ekzekutimit, certifikimit dhe pagesës.
2. Vlera e përfituar në kundërshtim me ligjin, nga burimi ose avantazhi publik, i kthehet buxhetit të shtetit nga përfituesi dhe personi përgjegjës, sipas bazës dhe procedurës përkatëse të përgjegjësisë pasurore. Vendimi përcakton shumën, mënyrën e llogaritjes, debitorin dhe mjetin e ankimit; detyrimi nuk prezumohet vetëm nga statusi.
3. Nuk pezullohen automatikisht pagesat e maturuara për punë e shërbime të ligjshme të palëve në mirëbesim dhe nuk shpallet automatikisht e pavlefshme kontrata. KQZ-ja nuk zëvendëson autoritetin kontraktor, Thesarin ose gjykatën për vlefshmërinë dhe dëmshpërblimin.
4. Referimi penal kryhet pa vonesë dhe nuk përdoret për të penguar masën parandaluese.
5. Për të njëjtat fakte, organet bashkërendojnë mbledhjen e provave, njoftimet dhe procedimet. Kur dy masa kanë natyrë ndëshkuese, garantohen qëllime plotësuese, lidhje e ngushtë në përmbajtje e kohë dhe proporcionaliteti i barrës së përgjithshme.
6. Kur këto kushte mungojnë dhe vazhdimi cenon ndalimin e ndëshkimit të dyfishtë, organi kompetent dhe gjykata zbatojnë mjetet ligjore për shmangien ose rishikimin e sanksionit.

Neni 91/35
Aktet zbatuese dhe bashkëpunimi

1. Rregullatori miraton me akt normativ vetëm rregullat dhe specifikimet teknike të sistemit, autentifikimit, ndërveprimit, arkivimit, formularëve elektronikë dhe publikimit. Të gjitha përcaktimet mbi kategoritë e ndaluara, testet, përjashtimet, afatet, subjektet, kompetencat, pasojat, sanksionet ose ankimin e përcaktuar në këtë Kod Zgjedhor dhe Aneksin A të tij, janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe nuk mund të ndryshohen apo interpretohen nga KQZ.
2. KQZ nuk mund të krijojë ndalime ose kundërvajtje të reja. KQZ ka të drejtën e ilustrimit të kategorive të ndaluara të përcaktuara në këtë Kod me shembuj konkretë.
3. Institucionet Shtetërore të auditimit, shërbimit civil, prokurimeve, financave, të dhënave personale dhe inspektimit bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë pa vonesë informacionin e domosdoshëm, nëpërmjet kanaleve të ligjshme e të sigurta. Kompetencat e tyre profesionale ruhen.
4. Ndalimet, detyrimet, masat parandaluese dhe sanksionet e këtij kreu zbatohen drejtpërdrejt nga miratimi dhe hyrja në fuqi e këtij ligji. Zbatimi i tyre nuk kushtëzohet nga krijimi, prokurimi, vënia në funksion ose ndërveprimi i sistemeve të reja elektronike, as nga miratimi i akteve normative apo teknike të KQZ-së.
5. Deri në vënien në funksion e sistemeve elektronike përkatëse, raportimi, kërkimi dhe shkëmbimi i informacionit, administrimi i provave dhe njoftimi i vendimeve kryhen sipas procedurës dokumentare standarde, nëpërmjet shkresës zyrtare ose komunikimit

elektronik institucional. Garantohet identifikimi i dërguesit, data e dërgimit dhe marrjes, integriteti i dokumenteve dhe gjurmueshmëria e veprimeve.
6. Institucionet publike paraqesin informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar në KQZ në mënyrën dhe afatet e përcaktuara në këtë Kod. Mungesa, mosfunksionimi ose mospërputhshmëria e një sistemi elektronik nuk justifikon mosraportimin, mosdhënien e informacionit apo moszbatimin e masës së ekzekutueshme.
7. Pas vënies në funksion të sistemeve elektronike, shkëmbimi i të dhënave kryhet nëpërmjet tyre për veprimet që mbulohen efektivisht. Procedura dokumentare mbetet e vlefshme kur sistemi ndërpritet, ekziston pamundësi objektive teknike ose informacioni kërkon trajtim të posaçëm sipas ligjit.
8. Rregullatori mund të miratojë rregulla teknike dhe formularë standardë për shkëmbimin e informacionit e monitorimin, duke përdorur sa më shumë regjistrat ekzistues. Këto akte normative kanë karakter ndihmës dhe nuk mund të shtyjnë, kufizojnë ose kushtëzojnë zbatimin e drejtpërdrejtë të këtij kreu.
9. Dispozitat për veprimtaritë zyrtare të seksionit VIII të këtij kreu zbatohen drejtpërdrejt nga organet kompetente të KQZ-së, sipas ndarjes së kompetencave të përcaktuar në Kod. Procedurat e ankimit dhe juridiksioni gjyqësor janë ato të parashikuara nga Kodi, me afatet e posaçme të përshpejtuara për masat parandaluese.
10. Rregullatori miraton brenda gjashtëdhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji aktet rregullatore e teknike për kalendarët, skedën e provave, monitorimin dhe publikimin. Mungesa e akteve teknike nuk pengon zbatimin e ndalimeve ligjore.
11. Për veprimtaritë e institucioneve publike, raportimi dhe pasqyrimi zbatohen sipas nenit 92 dhe nenit 91/25.
12. Për të njëjtin fakt nuk vendosen sanksione të dyfishta në zbatim të dispozitave të seksionit VIII të këtij kreu dhe të neneve të tjera të Kodit, kur mbrojnë të njëjtin interes juridik.”.

Neni 18

Neni 92 “Raportimi i veprimtarive publike” ndryshohet si më poshtë:

1. Institucionet qendrore e vendore, agjencitë, entet dhe shoqëritë nën kontroll publik raportojnë veprimtaritë publike sipas parashikimeve të Seksionit VIII. Publike është veprimtaria e hapur për publikun ose median ose që parashikon informimin publik rreth saj.
2. Kalendari i organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive publike paraqitet brenda shtatë ditëve nga fillimi i periudhës së mbrojtur zgjedhore. Veprimtaritë e reja ose të riplanifikuara njoftohen të paktën pesë ditë kalendarike përpara; ndryshimet materiale menjëherë. Për pamundësinë objektive dhe emergjencën zbatohet neni 91/26.
3. Për raportimin përgjigjet personi përgjegjës për drejtimin administrativ. Nëpunësi ndërlidhës ka të drejtë raportimi të drejtpërdrejtë. Titullari përgjigjet për urdhërimin, pengimin ose moszbatimin me faj, sipas rolit të provuar.
4. Nënkomisioneri kontrollon kryesisht ose mbi kërkesë dhe vendos masën sipas nenit 91/31. Vendimi shënohet menjëherë në regjistër me statusin “Ndaluar nga KQZ-ja”

dhe u njoftohet përgjegjësve. Mungesa e raportimit ose kalimi i afatit të raportimit nuk pengon ndërprerjen e veprimtarisë në zhvillim.
5. Veprimtaria e ndaluar nuk transmetohet si përmbajtje institucionale promovuese në radio e televizion. Përmbajtja e porositur ose sponsorizuar në platforma të tjera i nënshtrohet të njëjtit ndalim. Ruhet raportimi i pavarur gazetaresk, kritik e investigativ, sipas nenit 91/25.
6. Për shkeljet zbatohen dispozitat e posaçme të këtij Kodi.

Përpara nenit 92/1 shtohet titulli i kreut III të pjesës VII, me këtë përmbajtje:

"KREU III
FINANCIMI JOPUBLIK DHE KONTROLLI FINANCIAR".

Neni 19

Në nenin 92/3, pika 2, pas shkronjës "ç" shtohet shkronja "d" me këtë përmbajtje:
"d) vlerën dhe origjinën e materialeve e shërbimeve të prodhuara me burime institucionale dhe të ripërdorura në fushatë, kur përdorimi lejohet shprehimisht nga ligji. Raportimi nuk legalizon marrjen e një burimi publik të ndaluar. Vlerësimi bëhet me çmimin e tregut dhe, kur ky nuk përcaktohet, me koston e dokumentuar të prodhimit e shpërndarjes.".

Neni 20

Në nenin 106, pika 5 ndryshohet me këtë përmbajtje:
5. Anëtarët e KQV-së, që kanë lejuar një zgjedhës të votojë më shumë se një herë ose në emër të zgjedhësve të tjerë, mbajnë përgjegjësi penale, në përputhje me nenin 327/a i Kodit Penal, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 108 të këtij Kodi.

Neni 21

Në nenin 123/1, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Për kërkesat, ankesat dhe denoncimet që lidhen me neutralitetin e shtetit zbatohen drejtpërdrejt procedurat, legjitimimi dhe afatet e kreut II të pjesës VII të këtij Kodi. Afatet e vendosura me akt nënligjor nuk zëvendësojnë afatet e posaçme të këtij kreu.".

Neni 22

Në nenin 124, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

"7. Kërkesat për pavlefshmëri sipas nenit 160/1 paraqiten në afatet e pikave 2 dhe 3 të nenit 124 të këtij Kodi. Kërkuesi identifikon qendrat, zonën ose shtrirjen territoriale të prekur dhe paraqet faktet e provat e shkeljeve gjatë fushatës. Për këtë shkak nuk kërkohet që shkelja të ketë ndodhur brenda mjedisit të qendrës së votimit. Shqyrtimi dhe ankimi i vendimit bëhen sipas pjesëve X dhe XI, duke përfshirë nenin 132. Afatet

e nenit 91/33 nuk zbatohen për ankimin e pavlefshmërisë dhe të rezultatit të zgjedhjeve.”.

Neni 23

Në nenin 145 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në fjalinë e parë të pikës 1, fjalët “Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë” zëvendësohen me fjalët “Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”.
2. Në fund të pikës 2 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
“Për çështjet e neutralitetit shtetëror, shqyrtimi i mosveprimit dhe zgjidhja e çështjes në themel bëhen sipas nenit 91/33.”.
3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:
“4. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor shqyrton vendimet dhe mosveprimin e KAS-it për neutralitetin shtetëror, masat parandaluese, rivendosëse dhe sanksionet sipas nenit 91/33, përfshirë kërkesëpaditë e personave dhe autoriteteve të legjitimuara nga ai nen.”.

Neni 24

Në nenin 152 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:
“1. Ankimet sipas këtij Kodi paraqiten në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila ia kalon ato Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.”.
2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:
“4. Për çështjet e neutralitetit shtetëror zbatohen afatet e posaçme të nenit 91/33, të cilat kanë përparësi ndaj afateve të përgjithshme të këtij neni dhe afateve të shqyrtimit gjyqësor të pjesës XI.”.

Neni 25

Titulli i nenit 160 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:
1. Pavlefshmëria e zgjedhjeve në qendrën e votimit, zonën zgjedhore, ose në shkallë vendi.
2. Pika 1 e nenit 160 ndryshohet me përmbajtjen si vijon:
1. KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të subjekteve zgjedhore, i shpall zgjedhjet të pavlefshme në një apo më shumë qendra votimi, zona zgjedhore, ose në shkallë vendi në rast se:
3. Në pikën 1, të nenit 160, pas shkronjës “c” shtohet, shkronja “d” me përmbajtjen si vijon: “Për cilado shkaqe të tjera sipas parashikimeve të nenit 160/1, që kanë cenuar integritetin e zgjedhjeve në atë masë që mund të ketë ndikuar në rezultatin zgjedhor.

Neni 26

Pas nenit 160 shtohet neni 160/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 160/1

Pavlefshmëria për shkelje të rënda të neutralitetit dhe lirisë së votës

1. Shkelje e rëndë është përdorimi i organizuar, sistematik ose me ndikim të konsiderueshëm i funksionit apo burimeve shtetërore, me qëllim ndikimin dhe tjetërsimin në të drejtën e votës së zgjedhësit ose ndikimin në barazinë e garës, kur provohen veprimet, përgjegjësia dhe lidhja zgjedhore. Krahas sa mësipër, do të konsiderohen shkelje të rënda me ndikim në integritetin e zgjedhjeve edhe ato shkelje që cenojnë neutralitetin shtetëror në rastet si vijon:
   a) ndalimet e parashikuara në nenin 91/7 të këtij Kodi për propozimin, miratimin dhe nxjerrjen e akteve ligjore e nënligjore të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë me qëllim marrjen e përfitimeve zgjedhore;
   b) mbledhja ose tërheqja e përkohshme përpara ditës së votimit të dokumenteve zyrtare për identitetin e të dhënave biometrike të zgjedhësit si: letërnjoftim dhe ose pasaportë;

2. KAS-i, kryesisht ose me kërkesë të subjektit zgjedhor brenda afateve të ankimit të rezultatit, mund të shpallë të pavlefshme zgjedhjet në territorin zgjedhor të prekur nga shkelja e ligjit kur provohen bashkërisht:

a) fakte të qarta të shkeljeve serioze, të përhapura ose sistematike të neutralitetit, lirisë së votës ose barazisë së garës;

b) lidhja e tyre me burimet publike, presionin, patronazhimin ose mobilizimin e administratës;

c) natyra, shtrirja, intensiteti, kohëzgjatja dhe territori i prekur;

ç) mundësia e ndikimit në rezultat ose cenimi i integritetit të procesit në një masë që nuk riparohet me mjet më të butë.

3. Vlerësimi përfshin shkeljet gjatë fushatës edhe kur pasoja nuk përcaktohet drejtpërdrejt në një numër të identifikueshëm votash. Vështirësia e identifikimit të masës së ndikimit nuk përjashton detyrimin për të provuar faktet dhe lidhjen me rezultatin.

4. Pavlefshmëria shtrihet në qendrën, zonën ose, vetëm në rastin ekstrem, shtrirjen më të gjerë të provuar si të domosdoshme. Gjoba ose referimi penal nuk sjell automatikisht pavlefshmëri.

5. Vendimi arsyeton pamjaftueshmërinë e mjeteve më të buta dhe i nënshtrohet ankimit në Kolegjin Zgjedhor sipas rregullave të ankimit të rezultatit.”.

Neni 27

Pas nenit 160/1 shtohet neni 160/2 me titull dhe përmbajtje si vijon:

Neni 160/2.

Paligjshmëria e mandatit dhe masa korrigjuese ndaj kandidatit ose subjektit

1. Për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, ose për zgjedhjet për këshillat bashkiakë, në rast konstatimi të shkeljeve të rënda zgjedhore, të provuara dhe me shtrirje të mjaftueshme, kur kanë cenuar integritetin e rezultatit ose mund të kenë ndikuar në

ndarjen e mandateve, krahas konstatimit të paligjshmërisë së mandatit të fituar, merret masa korrigjuese e jashtëzakonshme e rishpërndarjes së mandatit të kandidatit ose subjektit zgjedhor në favor të subjektit vijues konkurrues politik që ka marrë rezultatin më të lartë zgjedhor.
2. Në kushtet e pikës 1 të këtij neni, Nënkomisioneri shtetëror i zgjedhjeve, pas verifikimit të fakteve e provave, në përputhje me afatin dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj zgjedhor, i përcjell për hetim dhe shqyrtim administrativ çështjen konkrete KAS-it.
3. KAS-i pasi verifikon dhe shqyrton gjithë elementët, faktet dhe provat e administruara, në rast se vlerëson se ndodhemi në kushtet e pikës 1 të këtij neni, konstaton paligjshmërinë e mandatit të fituar dhe brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit dërgon çështjen për shqyrtim dhe vendimarrje në Gjykatën Kushtetuese.
4. Për zgjedhjet për Kryetar Bashkie, në rast se ndodhemi në kushtet e pikës 1 të këtij neni, krahas konstatimit të paligjshmërisë së mandatit, do të aplikohet masa korrigjuese e përsëritjes së votimit.

Neni 28

Në nenin 161 "Përsëritja e zgjedhjeve" shtohen pikat 4/1 dhe 8 me këtë përmbajtje:

4/1. Në rast pavlefshmërie në zonën zgjedhore ose në tërë vendin, sipas parashikimit të shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 160 të këtij kodi.

8. Për pavlefshmërinë sipas nenit 160/1, përsëritja vendoset në të njëjtin vendim për shtrirjen në territorin zgjedhor të prekur nga shkelja e ligjit, me respektimin e afatit të pikës 6 të nenit 161.

Neni 29

Neni 162, pika 1, ndryshohet me këtë përmbajtje:

Përllogaritja e mandateve të subjekteve zgjedhore

Jo më vonë se 3 ditë nga përfundimi i procesit të ankimit kundër vendimit për miratimin e rezultateve të zonës zgjedhore apo pavlefshmërisë së zgjedhjeve, sipas këtij Kodi, KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që subjektet kanë marrë. Për zgjedhjet për Kuvendin përjashtohen nga shpërndarja e mandateve partitë politike që garojnë veçmas ose koalicionet që kanë

marrë më pak se 3% (tre përqind) të votave të vlefshme në shkallë vendi. [vlera e % është subjekt negociimi dhe dakordësimi].

Neni 30

Në nenin 163, pika 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

3. Mandatet për kandidatët fitues shpërndahen sipas rirenditjes së listës shumemërore në përputhje me rezultatet e votimit parapëlqyes sipas pikës 2 të këtij neni.

Në nenin 163, pika 4 ndryshohet me këtë përmbajtje:

4. Përllogaritja dhe shpërndarja e mandateve, sipas nenit 162 dhe këtij neni, miratohet me vendim të KQZ. Ndaj vendimit mund të bëhet ankim administrativ në KAS.

Neni 31

Pas nenit 163, shtohet neni 163/1 me titull "Ndarja e mandateve brenda koalicionit" dhe përmbajtje si më poshtë:

1. Menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit, sipas nenit 162 të këtij Kodi, KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve brenda koalicionit, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që secila parti pjesëtare e koalicionit ka marrë dhe numrit të mandateve që koalicioni ka fituar.
2. Numri i votave të vlefshme të secilës parti pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë tek të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror që i korrespondon dyfishit të numrit të mandateve që shpërndahen. Në rast se herësi që përftohet nga pjesëtimi është një numër me mbetje dhjetore, si herës merret numri i plotë më i afërt.
3. Herësit e përftuar nga çdo pjesëtim renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Në rast se herësi është një numër me mbetje dhjetore, si herës merret numri i plotë më i afërt. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen brenda koalicionit në zonën zgjedhore përkatëse.
4. Një parti politike përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni. Në rast se për vendin e fundit në listën e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni rezultojnë dy apo më shumë subjekte me të njëjtin herës, mandati i jepet atij subjekti që ka fituar numrin më të madh të votave dhe nëse ato kanë numër të barabartë votash, atëherë përcaktohet me short midis atyre partive. Shorti hidhet publikisht në KQZ, në prani të subjekteve të interesuara.
5. Menjëherë pas përfundimit të procedurave për ndarjen e mandateve për çdo parti politike, sipas këtij neni, KQZ-ja përcakton mandatet nominale për çdo parti politike,

në bazë të rirenditjes së kandidatëve në listë, sipas parashikimeve të nenit 163, pika 3 të këtij Kodi, në rend zbritës, duke filluar nga numri rendor një.
6. Shpërndarja e mandateve, miratohet me vendim. Vendimi mund të ankimohet në KAS dhe më pas në Kolegjin Zgjedhor, sipas procedurave të këtij Kodi, nga subjektet e parashikuara në pikën 1 të nenit 124, përfshirë edhe kandidatët e listës shumemërore.

Neni 32

Në nenin 166, pika 3, ndryshohet me këtë përmbajtje:

Mandatet e këshillave vendorë ndahen nga KQZ-ja në bazë të sistemit proporcional, sipas të njëjtave procedura të parashikuara në nenin 162, 163 dhe 163/1 të këtij Kodi. Mandatet nominale të këshillave vendorë ndahen bazuar në votimin parapëlqyes duke i rirenditur ato me rend zbritës, nga numri më i madh i votave tek numri më i vogël i votave për secilin kandidat brenda subjektit ose koalicionit zgjedhor.

Neni 33

Në nenin 171, pika 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

3. Shkelja e rregullave të përcaktuara në nenet 34 dhe 41 të këtij Kodi, përkatësisht nga sekretari i KZAZ-së ose KQV-së, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 30 000 deri në 60 000 lekë ose me burgim deri në 6 muaj.

Në nenin 171, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

"6. Për shkeljet e neutralitetit shtetëror zbatohen sanksionet dhe garancitë e posaçme të neneve 91/1–91/35. Sanksioni i përgjithshëm nuk zbatohet krahas atij të posaçëm për të njëjtin fakt.".

Neni 34

Në nenin 172, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Për keqpërdorimin e burimeve shtetërore, subjekti zgjedhor ose kandidati përgjigjet kur kërkon, bashkërendon, pranon me dijeni ose përdor me dijeni përfitimin, si dhe kur, pasi merr dijeni, nuk merr masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Kundërvajtja dënohet nga KAS-i me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë, të individualizuar sipas pikës 2. Krahas gjobës ndiqet kthimi i vlerës së përfituar në buxhetin përkatës. Për shkelje të rënda, të organizuara ose të përsëritura, KAS-i mund të ulë financimin publik të fushatës deri në vlerën e avantazhit të provuar. Përfitimi objektiv, pa dijeni ose bashkëpunim, nuk mjafton për sanksionim.".

Neni 35

Kodit i shtohet Aneksi A "Formulari i vlerësimit të neutralitetit zgjedhor", bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesë përbërëse e tij.

Neni 36
Dispozita kalimtare

1. Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në detyrë, vijon të ushtrojë mandatin e tij deri në përfundim të afatit 7-vjeçar të ushtrimit të mandatit.
2. Kompetencat e reja të Nënkomisionerit fillojnë me hyrjen në fuqi.
3. Kuvendi përshtat strukturën dhe organikën e KQZ-së brenda gjashtëdhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Deri atëherë Nënkomisioneri mbështetet nga administrata ekzistuese.
4. Rregullatori miraton rregullat dhe aktet teknike brenda gjashtëdhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Mungesa e tyre ose e sistemit elektronik nuk pengon zbatimin e ndalimeve, masave, raportimit dokumentar dhe ankimit.
5. Institucionet Shtetërore caktojnë nëpunësin ndërlidhës me KQZ brenda tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Kur periudha e mbrojtur zgjedhore ka filluar, detyrimet e reja të paraqitjes së kalendarëve dhe të dhënave fillestare përmbushen brenda shtatë ditëve nga hyrja në fuqi; nuk sanksionohet mosrespektimi i një afati të kaluar përpara kësaj date.

Neni 37
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ANEKSI A

FORMULARI I VLERËSIMIT TË NEUTRALITETIT ZGJEDHOR
Pushteti normativ, fiskal dhe social

Qëllimi. Formulari dokumenton kontrollin paraprak dhe pasues të masave me rëndësi zgjedhore. Plotësimi i tij nuk legalizon një masë që plotëson objektivisht kushtet e ndalimit dhe nuk zëvendëson kompetencën vendimmarrëse të Nënkomisionerit.
Për ligjet dhe aktet normative me fuqinë e ligjit, pasojat e formularit zbatohen sipas nenit 91/10, pikat 5 deri në 7. Formulari dhe vendimi administrativ nuk pezullojnë votimin, shpalljen, botimin ose fuqinë juridike jashtë procedurave dhe kompetencave kushtetuese.

A. IDENTIFIKIMI I MASËS

Fusha	**Plotësimi**
Institucioni	
Njësia propozuese	
Titulli / objekti i masës	
Lloji i aktit	☐ Ligj ☐ Akt normativ ☐ VKM ☐ Urdhër ☐ Akt vendor ☐ Akt rregullator ☐ Tjetër
Nr. unik i regjistrimit	Gjenerohet nga sistemi
Versioni	V___
Data e nisjes	
Data e parashikuar e miratimit	
Data e hyrjes në fuqi	
Data e materializimit të efektit / pagesës	
Hartuesi / struktura	
Propozuesi formal	
Burimi real i nismës, nëse ndryshon	

B. FILTRI I PARË – FUSHA E KONTROLLIT

1. A krijon, ndryshon, zgjeron, ul, fal, shtyn ose ndikon masa në një nga kategoritë e mëposhtme?

_____

☐ Pagë
☐ Pension

☐ Bonus / pagesë shtesë
☐ Subvencion
☐ Ndihmë sociale ose ekonomike
☐ Taksë / tarifë
☐ Falje detyrimi / kamatëvonesë
☐ Transferim financiar
☐ Përfitim pasuror
☐ Privatizim / dhënie pasurie
☐ Shtyrje ose mosekzekutim detyrimi
☐ Përfitim tjetër ekonomik, financiar ose social
☐ Asnjërën

2. Klasifikimi i masës:

☐ E njëhershme
☐ Periodike
☐ Automatike
☐ Pjesë e një skeme të qëndrueshme
☐ Emergjente
☐ Tjetër

RREGULLI I KONTROLLIT: Nëse masa është e njëhershme dhe krijon përfitim për kategori të popullsisë gjatë periudhës së mbrojtur, procedura kalon te Seksioni C për verifikimin e ndalimit drejtpërdrejt nga ligji dhe të përjashtimeve të kufizuara.

C. MASA E NJËHERSHME

3. A është masa e njëhershme ?

☐ PO
☐ JO

4. Nëse PO, a përbën vetëm ekzekutim të një të drejte të krijuar më parë nga:

☐ Ligji
☐ Vendim gjyqësor i formës së prerë
☐ Kontratë ekzistuese
☐ Formulë automatike
☐ Skemë e qëndrueshme
☐ Asnjë prej tyre

5. Nëse nuk hyn në rastet e mësipërme, a mbështetet në:

☐ Fatkeqësi natyrore
☐ Emergjencë

☐ Nevojë tjetër objektive të jashtëzakonshme të parashikuar nga ligji
☐ Asnjë

Dokumentacioni që provon përjashtimin:

_____

_____

REZULTAT I FILTRIT: Në mungesë të një përjashtimi ligjor të zbatueshëm – MASË E NDALUAR DREJTPËRDREJT NGA LIGJI.

D. MASA E MIRATUAR PËRPARA PERIUDHËS SË MBROJTUR

6. A është miratuar masa përpara fillimit të periudhës së mbrojtur?

_____

☐ PO
☐ JO

7. A është materializuar plotësisht përfitimi përpara fillimit të periudhës?

_____

☐ PO
☐ JO

8. Nëse JO: a do të ishte e ndaluar masa, ose ndryshimi, përshpejtimi, zgjerimi apo materializimi i saj, po të vendosej gjatë periudhës së mbrojtur?

_____

☐ PO
☐ JO

Kontrolli përfshin jo vetëm aktin fillestar, por edhe çdo vendim ose veprim gjatë periudhës së mbrojtur që ndryshon vlerën ose përfituesit, përshpejton afatin/grafikun, zgjeron shtrirjen ose materializon përfitimin.

PASOJA: Nëse përgjigjja është PO, ekzekutimi dhe efekti i pamaterializuar pezullohen deri në përfundimin e periudhës së mbrojtur, përveçse kur masa anulohet ose shfuqizohet më parë.

Përjashtim nga pezullimi: pagesat periodike normale, detyrimet e ekzekutueshme, formulat automatike dhe skemat e qëndrueshme të krijuara më parë, kur gjatë periudhës nuk ndryshohen vlera, përfituesit, formula, afati ose grafiku i zbatimit dhe i materializimit.

E. TESTI I VAZHDIMËSISË NORMALE

9. A ishte masa e parashikuar përpara periudhës së mbrojtur?

_____

☐ PO
☐ JO

Nëse PO, baza:

_____

☐ Ligj
☐ Buxhet
☐ PBA

☐ Program shumëvjeçar
☐ Kontratë
☐ Formulë automatike
☐ Plan investimi
☐ Tjetër

Elementi	PO	JO	Është ndryshuar pas fillimit të periudhës
Përfituesit	☐	☐	☐
Vlera	☐	☐	☐
Formula	☐	☐	☐
Afati	☐	☐	☐
Data / grafiku i pagesës ose efektit	☐	☐	☐

Dokumentet që provojnë vazhdimësinë:

_____

_____

F. TESTI MATERIAL: NORMALITET – DEVIJIM – SELEKTIVITET – KOHA

10. NORMALITETI – A është masa pjesë e ushtrimit të zakonshëm dhe periodik të funksionit publik?

_____

☐ PO
☐ JO

Shpjegimi dhe dokumentet:

_____

_____

11. DEVIJIMI – A ndryshon masa nga ligji, formula, programi, praktika ose kalendari i mëparshëm?

_____

☐ PO
☐ JO

Nëse PO, çfarë ndryshon dhe pse pikërisht tani?

_____

_____

12. SELEKTIVITETI – Cilët janë përfituesit?

_____

Numri i përfituesve:

_____

Shpërndarja territoriale:

_____

13. A përqendrohet masa te një kategori ose territor i caktuar?

_____

☐ PO

☐ JO

Arsyeja objektive:

_____

_____

14. KOHA – Pse masa duhet të miratohet ose zbatohet gjatë periudhës së mbrojtur dhe jo pas përfundimit të saj?

_____

_____

_____

G. TESTI QENDROR

A DO TË PROPOZOHEJ, MIRATOHEJ DHE ZBATOHEJ E NJËJTA MASË, NË TË NJËJTËN KOHË, ME TË NJËJTËT PËRFITUES, ME TË NJËJTËN VLERË DHE ME TË NJËJTIN EFEKT, SIKUR TË MOS KISHTE ZGJEDHJE?

☐ PO

☐ JO

Faktet dhe dokumentet që mbështesin përgjigjen:

_____

_____

_____

H. FRAGMENTIMI, ATRIBUIMI DHE SHMANGIA

15. A lidhet masa me akte, vendime, pagesa ose programe të tjera?

_____

☐ PO

☐ JO

Nëse PO, identifikojini:

_____

_____

16. A prodhojnë masat, të vlerësuara së bashku, një përfitim ose efekt që nuk rezulton nga secila veçmas?

_____

☐ PO

☐ JO

17. A realizohet masa drejtpërdrejt ose tërthorazi nëpërmjet:

_____

☐ Ndërmarrjeje shtetërore
☐ Bashkie / njësie vendore
☐ Agjencie
☐ Fondi publik
☐ Shoqërie me kapital publik
☐ Personi juridik privat
☐ OJF / fondacioni
☐ Ndërmjetësi tjetër
☐ Jo

Burimi i financimit:

_____

Organi/personi që kontrollon, urdhëron, koordinon ose mundëson masën:

_____

_____

I. KOMUNIKIMI DHE PREMTIMI ZYRTAR

18. A është komunikuar publikisht masa?

_____

☐ PO
☐ JO

Nga kush?

_____

☐ Faqe institucionale
☐ Rrjete sociale zyrtare
☐ Konferencë shtypi
☐ Aktivitet publik
☐ Media
☐ Tjetër

19. A është paraqitur si vendim ose angazhim i shtetit për një përfitim që ende nuk mund të miratohet ose zbatohet ligjërisht?

_____

☐ PO
☐ JO

Shpjegimi / prova:

_____

_____

J. DOKUMENTIMI I PËRGJEGJËSISË

Faza	Emri / funksioni	Data / ora	Veprimi / dokumenti
Konceptoi			
Hartoi			
Vlerësoi			
Propozoi			
Futi në rend dite			
Procedoi			
Miratoi / firmosi			
Autorizoi botimin			
Autorizoi ekzekutimin			
Ekzekutoi pagesën / përfitimin			

K. VLERËSIMI I NËPUNËSIT NDËRLIDHËS

20. Nga të dhënat e mësipërme rezulton:

_____

- ☐ Masa nuk hyn në fushën e ndalimit
- ☐ Masa kërkon kontroll nga Nënkomisioneri
- ☐ Ekziston tregues i një kushti ndalues
- ☐ Masa është e njëhershme e ndaluar
- ☐ Masa është miratuar më parë, por ekzekutimi duhet pezulluar
- ☐ Pretendohet përjashtim për emergjencë / nevojë objektive të jashtëzakonshme

Arsyetimi:

_____

_____

_____

Shënim: Ky vlerësim nuk zëvendëson kompetencën e Nënkomisionerit dhe nuk legalizon një masë që objektivisht plotëson kushtet e ndalimit.

L. DEKLARATA PERSONALE

Deklaroj se informacioni i paraqitur në këtë formular dhe dokumentacioni bashkëlidhur janë, sipas dijenisë sime dhe verifikimeve që më kërkon funksioni, të plotë dhe të sakta; se nuk kam fshehur akt, ndryshim, përfitues, efekt financiar, afat, lidhje me masa të tjera ose rrethanë që mund të ndikojë në vlerësimin e neutralitetit

zgjedhor; dhe se jam njohur me përgjegjësinë ligjore për deklarim të rremë, fshehje ose paraqitje të pasaktë të të dhënave.

Emri dhe mbiemri	Funksioni	Nënshkrimi elektronik	Data / ora

M. PJESA E NËNKOMISIONERIT

21. Statusi i çështjes:

_____

- ☐ Jashtë fushës së ndalimit
- ☐ Procedurë kontrolli e hapur
- ☐ Kërkohen dokumente shtesë
- ☐ Pezullim parandalues
- ☐ Kusht ndalues i konstatuar
- ☐ Ekzekutim i pezulluar
- ☐ Përjashtim i ligjshëm
- ☐ Procedurë e mbyllur

22. Pasoja sipas fazës:

_____

- ☐ Nuk procedohet
- ☐ Nuk futet në rend dite
- ☐ Nuk procedohet për votim sipas Rregullores së Kuvendit
- ☐ Nuk botohet
- ☐ Nuk ekzekutohet
- ☐ Nuk paguhet / materializohet
- ☐ Ekzekutimi i masës së miratuar më parë pezullohet
- ☐ Referim për sanksion
- ☐ Tjetër pasojë e përcaktuar nga Kodi

Arsyetimi i vendimit:

_____

_____

Vendimi nr.	Data / ora	Nënkomisioneri / nënshkrimi